# GAZETA SHQIPTARE







Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7636 E enjte 30 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)







In Memoriam

Nga ATJON ZHITI

**Bisedë e lirë me një shoqe. Bëj ç'të duket më e bukur…**

Studenti i Filozofisë Atjon V. Zhiti sot, në 30 gusht, do të ishte 23 vjeç. Ai la pas një libër me ese, një album me piktura dhe shumë ilustrime të tijat në botime ...

Vijon në faqen 20





Opinioni i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

**Misioni i "dhëndrit" shqiptar**

Berat Albayrak, ministri i Financave dhe i Thesarit i Turqisë që nga korriku 2018, është mbiquajtur nga disa media turke si "dhëndri shqiptar", duke ...

Vijon në faqen 21





Gëzim Hysaj e Agron Mollaj, 1 javë "pa gjurmë"

## Zhduken dajë dhe nip në Shkodër, dëshmia: Më 23 gusht i thirrën "dil" dhe s'i pamë më

Saimira Hysaj: I kërkoj shtetit të më gjejë burrin. Merita Molla: Telefonin e la në shtëpi

SENAD NIKSHIQI

Prej 6 ditësh Gëzim Hysaj banues në njësinë Postribë në Shkodër dhe Agron Mollaj banues në fshatin Dobraç të njësisë Rrethina janë zhdukur pa lënë asnjë gjurmë. Gëzimi është daja i Agronit dhe që të dy kanë humbur ...

Në faqen 8

INTERVISTA/ "APLIKUAN 18 MIJE MATURANTE, KU DUHET TE KENE KUJDES FITUESIT"

# MYNYR KONI: SI DO TE BEHET REGJISTRIMI NE UNIVERSITET

Rektori i Universitetit të Tiranës flet për "GSH": Juridiku dega më e preferuar, 6500 aplikime për 700 kuota. Si do veprohet me ankimimet e maturantëve



*(Në foto)* Rektori i Universitetit të Tiranës, Mynyr Koni

Në faqen 7

PRESIDENTI

**Meta: Ndryshimi i kufijve të Kosovës cenon stabilitetin, devijime pa dobi**

Në faqen 4

VENDIMI I PLOTE

**Të përndjekurit, qeveria ndryshon skemën e pagesës së kësteve**

Në faqen 5

SPEKTAKLI

**Juna Manaj: Ja emocionet që përjetova në "German Idol"**

Suplement

NGA DASHNOR KALOÇI



**Raporti sekret i Spiro Kolekës: Në Pogradec, 21 pyetje për Mehmet Shehun**

Në faqet 18-19

Gjykata sqaron bisedën mes Denar Bibës dhe gjyqtarit Ledi Bianku

## Strasburgu: Qeveria, kërkesë zyrtare për pronat

*Bllofi i audio-përgjimit: Gjykata e huaj vendosi të shtyjë rastet*

Gjykata e Strasburgut reagoi dje lidhur me përgjimin e publikuar mes nënkryetarit të KQZ-së Denar Biba dhe gjyqtarit shqiptar në Strasburg Ledi Bianku, ku nga ajo që kuptohej nga biseda, akuzat e opozitës dolën bllof. Atë që kërkoi Denar Biba në





kafe me Ledi Biankun, atë kërkoi edhe qeveria zyrtarisht në Strasburg, pra pezullimin e një vendimi për çështjen e pronave. Gjykata e Strasburgut në reagimin e saj deklaron se Denar Biba ishte zyrtari i afërt me qeverinë ...

Në faqet 2-3

DENTISTE E FARMACISTE

**Lista e dytë, fituesit në Universitetin e Mjekësisë**

Në faqet 10-11

## STRASBURGU
### PERGJIMI

Audio-përgjimi, Biba: Basha dhe Bardhi s' kuptojnë ligjin dhe procedurën e Gjykatës së Strasburgut,

# Biba: Biseda me gjyqtarin për një vendim të marrë nga Gjykata

*"Kërkohej shtyrja e afatit të ekzekutimit"*



Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut

Valentina Madani

Nënkryetari i Komi sionitZgjedhor Denar Biba reagoi sërish dje në lidhje me përgjimin e publikuar mes tij dhe gjyqtarit shqiptar në Strasburg Ledi Bianku. Biba përmes një postimi në rrjetet sociale shprehet se është i habitur me kreun e PD-së Lulzim Basha, por edhe ish-ministrin e Drejtësisë Gazment Bardhi për mënyrën se si ata i kuptojnë ligjin dhe sa pak e njohin procedurën në Gjykatën e Strasburgut. Pas publikimit të bisedës mes Bibës dhe gjyqtarit Bianku, opozita akuzoi qeverinë se përmes Denar Bibës kishte shantazhuar gjyqtarin shqiptar në Strasburg për pronat e shqiptarëve. Por Biba në përgjigjen e tij u bën disa pyetje Bashës dhe Bardhit, por thotë se nuk pret përgjigje nga ata. "Përse del sot ky përgjim i qepur si mos më keq dhe ku është e gjithë pjesa tjetër e bisedës krejt normale mes meje e mikut tim, ku unë i flas për sakrificën time e jo të atij? Ku doni të dilni me kë të , të nderuar kolegë juristë , ndërkohë që e dini edhe vetë se sa e turpshme është e gjitha kjo?", shkruan Denar Biba. Sipas tij biseda me z.Bianku nuk kishte lidhje me vendimin gjyqësor në Strasburg, por me një vendim të marrë nga Gjykata për të Drejtat e Njeriut. "A e dini që biseda nuk kishte lidhje me marrjen e një vendimi gjyqësor, por me një vendim tashmë të marrë nga Gjykata; thjesht kërkohej shtyrja e afatit të ekzekutimit të tij?

A e dini që Shteti shqiptar e kishte marrë edhe me herët një shtyrje prej 18 muajsh në lidhje me ekzekutimin e detyrimit ndaj ish-pronarëve dhe se "moratoriume" të ngjashme shtetet palë të Konventës kanë të drejtë legjitime t'i kërkojnë kur të duan e sa herë të duan?

A e dini që kjo tipologji kërkesë s'ka të bëjë fare me vendimmarrjen tradicionale gjyqësore të GJEDNJ në lidhje me ankimet ndaj shteteve palë, por është një kërkesë e pastër politike dhe produkt i një vendimmarrjeje politike, në varësi të situatës politiko-ekonomike e sociale që kalon shteti përkatës?", shprehet z.Biba. Sepse shton ai "ndikimi i paligjshëm" synon të përfitojë përmes premtimit diçka që përndryshe, në respekt të fakteve, ligji e ndalon. "Çfarë paligjshmërie është të diskutosh, t'i marrësh mendim, apo qoftë edhe të përpiqesh të bindësh cilindo, qoftë ky edhe një gjyqtar i Gjykatës së Strasburgut, për të siguruar një shtyrje afati deri sa situata në vend të rregullohet përmes një ligji të shtetit tënd? A mund të më tregoni nenin dhe ligjin që kam shkelur?". Denar Biba pyet më tej: "Si ka mundësi që nuk reagoi Gjykata e Strasburgut pasi u vu në dijeni nga z.Bianku se ndaj tij ishte ushtruar një ndikim i papërshtatshëm?

Çfarë konkretisht ka ndodhur mes vitit 2014, kur unë e kam bërë atë bisedë në kafene me mikun tim Ledi Bianku e deri më sot?". Z.Biba e mbyll kundërpërgjigjen e tij për PD-në duke thënë : "Natyrisht, s'pres përgjigje as nga zoti Basha e as nga zoti Bardhi, por kam të drejtë si qytetar të pres që mediat të hedhin dritë mbi kë të legen plot me llum të zi".



Nënkryetari i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Denar Biba

**REAGIMI**

Denar Biba pyet: "Si ka mundësi që nuk reagoi Gjykata e Strasburgut pasi u vu në dijeni nga z.Bianku se ndaj tij ishte ushtruar një ndikim i papërshtatshëm? Çfarë konkretisht ka ndodhur mes vitit 2014, kur unë e kam bërë atë bisedë në kafene me mikun tim Ledi Bianku e deri me sot?"

### "Zgjidhje edhe qytetarëve jashtë kufijve"

## Rama bën bilancin: 50 mijë ankesa në portalin e bashkëqeverisjes

Përpara nisjes së sezonit politik, kryeministri Edi Rama u kujtoi dje qytetarëve platformën e bashkëqeverisjes ku mund të shkruajnë problemin e tyre dhe të marrin zgjidhje. Eksperienca e deritanishme në shifra për këtë platformë për kryeministrin është e suksesshme. "4439 qytetarë janë drejtuar platformës qysh prej 1 korrikut. Ka kaluar 50 mijë numri i qytetarëve që janë përfshirë në platformë", tha z.Rama. Për të ilustruar suksesin dhe për ta bërë platformën tërheqëse për njerëzit, kryeministri kishte ftuar në zyrën e tij edhe njerëz të cilët nëpërmjet kësaj mënyre kishin marrë zgjidhje për problemin e tyre. Edi Rama deklaroi se platforma e bashkëqeverisjes është rruga më e shpejtë për të zgjidhur hallet pa pasur nevojën e mikut apo ryshfetit. Gjatë takimit me koordinatorët e bashkëqeverisjes, Rama deklaroi se platforma online po jep rezultate, pasi ka nisur pastrimi i parazitëve nga administrate. "Parazitët po largohen nga administrata. Platforma e bashkëqeverisjes është rrugë më e shkurtër se e mikut. Mjaftojnë vetëm tre minuta dhe merrni zgjidhje. Ju lutem, na vini në provë për zgjidhjen e problemeve që keni me administratën. ", deklaroi z.Rama.

**SIGURIA**

"Për sa i përket sigurisë, kemi sezonin turistik me shifrat më pozitive. Në rast se nuk do të kishim atë tragjedinë e Vlorë, ku patëm 8 të vrarë, në një masakër haluçinante, do të kishim numrin më të ulët me diferencë të vrasjeve në këtë periudhë. Pa llogaritur faktin që kemi qenë efektivë me këto krimet e vogla", tha Rama në Lezhë.



### PD: Buxheti po shpërndahet për miqtë Ramës

PD akuzoi sërish dje kryeministrin Rama se po shpërndan tenderë me para publike në persona të afërt me të. Për demokratët i tillë është rasti i kompanisë së biznesmenit Agron Papuli që ka përfituar 127 tenderë me vlerë 17.3 milionë euro. "Kompanisë së mikut të Ramës, Agron Papuli, siç provohet edhe në dokumentet zyrtare nga Agjencia e Prokurimit Publik në muajin korrik të këtij viti i është dhënë tenderi e radhës. Bëhet fjalë për një tender me objekt "qira operacionale automjetesh nga Policia e Shtetit, 1.8 milionë euro", theksoi deputeti Flamur Noka. Por akuzave të opozitës për abuzim me tenderë, iu përgjigj këshilltari për media i kryeministrit, Endri Fuga. Në një postim shkurt në 'Twitter', Fuga shprehet se është e kotë t'u përgjigjesh për çdo budallallëk. Sipas tij, kryeministri dhe qeveria janë të fokusuar te njerëzit dhe puna në shërbim të tyre.



### Nishani: Shantazhimi krim i rëndë, s'harrohet

Ish presidenti Bujar Nishani e cilësoi dje si një tjetër skandal të madh të qeverisë 'Rama', audio-regjistrimin e shantazhimit nga ana e qeverisë shqiptare ndaj një gjykatësi të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Sipas tij "shantazhimi i Gjyqtarit të Gjykatës Evropiane nuk mund të kalojë e as të harrohet me një njoftim formal "se kanë nisur hetimit". Ai është një krim i rëndë penal në juridiksionin shqiptar, por edhe atë evropian". "Në këto vite të lobimit për ngrirje të gjykimit dhe vendimeve për pronat e shqiptarëve nga Strasburgu u qartësua edhe më shumë synimi i vërtetë i kleptokratëve të Tiranës. Nga njëra anë zero vendime të reja në pesë vite për njohjen e të drejtës mbi pronën e grabitur.",-tha z.Nishani.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Dossier:** Iv Kaloçi, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli,
***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI. ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415***-email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Dalin bllof akuzat e opozitës: Qeveria, kërkesë zyrtare për pronat

# Përgjimi, Gjykata e Strasburgut sqaron çështjen Biba-Bianku

## "Kërkesa ishte për kthimin dhe kompensimin e pronave"

Gjykata e Strasburgut reagoi dje lidhur me përgjimin e publikuar mes nënkryetarit të KQZ-së Denar Biba dhe gjyqtarit shqiptar në Strasburg Ledi Bianku, ku nga ajo që kuptohej nga biseda, akuzat e opozitës dolën bllof. Atë që kërkoi Denar Biba në kafe me Ledi Biankun, atë kërkoi edhe qeveria zyrtarisht në Strasburg, pra pezullimin e një vendimi për çështjen e pronave.

Gjykata e Strasburgut në reagimin e saj deklaron se Denar Biba ishte zyrtari i afërt me qeverinë në 2014-n dhe se kërkesa ishte për kthimin dhe kompensimin e pronave. Bianku kishte informuar se sjellja e tij (Denar Bibës) ishte e papërshtatshme. Sipas Gjykatës së Strasburgut për të Drejtat e Njeriut, pasi sjellja e Denar Bibës që përfaqësonte qeverinë shqiptare është konsideruar, gjyqtari Bianku ka informuar Presidentin e Gjykatës Dean Spielmann dhe më pas edhe pasardhësin e tij Guido Raimondi, sapo u zgjodh. "Në përgjigje të pyetjeve tuaja, Gjykata Europiane për të drejtat e njeriut, mund të informojë, si më poshtë: 1.Një gjykim pilot, Manushaqe Puto kundër Shqipërisë, i është dorëzuar Gjykatës në 31 korrik 2012, me shqetësimin e mosekzekutimit të një vendimi përfundimtar administrativ dhe vendime gjyqësor për sa i përket kompensimit të pronarëve për pronën e shpronësuar gjatë regjimit komunist në Shqipëri. Në këtë gjykim, Gjykata vendosi që ai nuk mund të shtynte shqyrtimin e rasteve të paraqitura tashmë (pika 7 e dispozitave operative). Gjithsesi ajo u shty për një periudhë 18 muaj nga data në të cilën gjykimi u bë përfundimtar dhe çdo aplikim i paraqitur pas dorëzimit të gjykimit (pika 8 e dispozitave operative). Duhet të vëmë në dukje se sipas rregullit 61, pika 1 a e Rregullores të Gjykatës, në kontekstin e një gjykimi pilot, është në dorën e Gjykatës të shtyjë shqyrtimin e aplikimeve të ngjashme, duke mbajtur pezull adoptimin e masave për kompensimin e kërkuar në nivel kombëtar.2. Në vitin 2014, një zyrtar i afërt me qeverinë shqiptare, (zoti Denar Biba) kontaktoi zotin Ledi Bianku, gjyqtar përfaqësues i Shqipërisë, duke i kërkuar që gjykata të shtyjë shqyrtimet e rasteve për rikthimin ose kompensimin e pronës. Gjyqtari Bianku, tregoi këtij personi se kjo sjellje ishte e papërshtatshme dhe menjëherë informoi Dean Spielmann, president i Gjykatës Europiane në atë kohë. Ai në vazhdim informoi Presidentin e Gjykatës, Guido Raimondi, sapo i ai u zgjodh.3. Një kërkese zyrtare për shtyrjen e rasteve për kthim dhe kompensim të pronave ishte bërë në të njëjtën datë, në kuadrin e takimit mes autoriteteve të Gjykatës Europiane dhe Autoriteteve shqiptare. Kjo kërkesës u trajtua me të njëjtin refuzim kategorik. Në veçanti, çdo vendim i tillë, ra brenda kompetencave të Dhomës, përpara secilit prej rasteve në pritje dhe nuk mund të shqyrtoheshin nga Presidenti i Gjykatës. Për më tepër, një kërkesë e tillë mund të shqyrtohej vetëm në përputhje me rregullat procedurale normale. 4. Kështu që nuk ka pasur, as nuk mund të ketë ndonjë "marrëveshje" mes Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Shqipërisë, për sa i përket shtyrjes së mundshme të rasteve në fjalë. 5.Rrjedhimisht, në 2016, Dhoma kompetente e Gjykatës, vendosi të shtyjë shqyrtimet e këtyre rasteve. Gjithsesi, kjo shtyrje nuk ka lidhje me ngjarjet e vitit 2014. Gjyqtari Bianku, nuk pori pjesë në këtë vendim, sepse ishte tërhequr nga këto raste, thuhet në reagimin e Strasburgut për "Fax News". 6.Të gjitha vendimet e Gjykatës mbi rastet, janë marrë në përputhje me ligjin dhe me procedurat e vendosura nga Rregullorja e Gjykatës.



Gjyqtari Ledi Bianku

**PETRIT VASILI**

Kreu i deputetëve të LSI Petrit Vasili deklaroi dje: "Edhe Gjykatës së Strasburgut, kryeministri ordiner i vuri çmim si dhe çoi tregtarin e tij për ta blerë. Drejtësia e re po ngrihet si listë çmimesh në pazarin e kryeministrit dhe si e tillë ajo është vetëm një drejtësi horrash".

### PS: Audio-regjistrimi, muhabet kafenesh

## Shantazhi i qeverisë, PD: Bianku u ankua te kreu i Gjykatës

Ankesa që ka bërë Ledi Bianku, gjyqtari i Gjykatës së Strasburgut pranë kryetarit të kësaj gjykate pas takimit me Denar Bibën, për demokratët është prova që audio-regjistrimi i publikuar të martën është i vërtetë dhe, siç është e vërtetë për ta se Edi Rama me ndërhyrje të tillë synonte ndihmë për qeverinë kundër interesave të pronarëve shqiptarë. Këshilltari ligjor i PD deklaron se gjyqtari i Strasburgut Ledi Bianku rrëzoi justifikimin e nënkryetarit të KQZ, Denar Biba duke denoncuar shantazhin te kreu i gjykatës. "Gjyqtari shqiptar në Strasburg ka konfirmuar se në përputhje me detyrimet e tij etike dhe ligjore, pas takimit me Denar Bibën, ka informuar Kryetarin e atëhershëm të Gjykatës së Strasburgut, duke e cilësuar mesazhin e të dërguarit të qeverisë si ndikim të papërshtatshëm. Mjafton ky pohim për të kuptuar përpjekjen qesharake të sekserit të Edi Ramës dhe Engjëll Agaçit për t'u thënë shqiptarëve se nuk është ashtu siç duket, se shantazhi nuk është shantazh, por miqësi e vjetër",- theksoi z.Bardhi. Por ndryshe mendojnë socialistët, të cilët me këtë qëndrim të demokratëve pas publikimit të audio-përgjimit mendojnë se opozita e Bashës ka prekur fundin. Ulsi Manja, nga selia rozë deklaroi se qëndrimi i qeverisë së Ramës për t'iu drejtuar Gjykatës së Strasburgut ka qenë publik në 2014 dhe i kushtëzuar pas borxheve të papaguara për ish-pronarët nga qeveria Berisha. "Dhe i shantazhuari, Ledio Bianku, miku i Denar Bibës, që s'ka asgjë në dorë në Strasburg për gjithë sa flitet dhe kjo është lehtësisht e verifikueshme, paska heshtur katër vjet! Në fakt, opozita e sotme, dje në pushtet, e di shumë mirë çështjen e pronave dhe detyrimet që duhet të përmbushte qeveria shqiptare nga viti 2012 deri në qershor të vitit 2014 sipas vendimit pilot të Gjykatës së Strasburgut!",- tha z.Manja.




**EDITH HARXHI**

Ish-zv. ministrja e Jashtme Edith Harxhi reagoi ndaj skandalit të audio-përgjimit ku shantazhohej anëtari shqiptar i Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Harxhi shkruan në 'Fb' se "para 70 vjetësh, baballarët e tyre u morën forcërisht pronat gjyshërve tanë, ndërsa sot fëmijët e tyre po na marrin edhe të drejtën për të kërkuar drejtësinë sipas ligjeve ndërkombëtare".



### Biseda e përgjuar Biba-Bianku

## Prokuroria kërkon të sekuestrojë audion

Prokuroria e Tiranës ka regjistruar zyrtarisht veprën penale "ushtrim ndikimi ndaj personave që mbajnë funksione publike", për audio-përgjimin e bisedës mes nënkryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Denar Biba dhe gjyqtarit shqiptar në Gjykatën e Strasburgut, Ledi Bianku. Organi i hetimit ka nisur paraditen e të mërkurës verifikimin për këtë çështje. Burime zyrtare nga prokuroria e kryeqytetit konfirmojnë se drejt portalit që publikoi bisedën është dërguar një shkresë ku kërkohet vënia në dispozicion e materialit të plotë. Pas kësaj, audio do t'i nënshtrohet një ekspertimi për të saktësuar nëse është origjinali apo ka pasur ndërhyrje. Pasi të kryhen këto veprime hetimore, prokuroria do të vendosë nëse do të thërrasë për t'i marrë në pyetje dy personat që dëgjohen në audio-përgjim apo edhe emrat e atyre që përmenden aty. Nëse nga verifikimi prokurorët do të arrijnë në përfundimin se është kryer vepra penale e ushtrimit të ndikimit ndaj personave që mbajnë funksione publike apo ndonjë vepër tjetër, atëherë do të nisë një hetim penal. Opozita i kërkoi prokurorisë të hetojë edhe për korrupsion Denar Bibën dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kryeministrisë, Engjëll Agaçin, për shantazh ndaj gjyqtarit Bianku.

NDRYSHIMI I KUFIJVE
INTERVISTA

Referendumi, presidenti thirrje shqiptarëve në Maqedoni: Votoni pro marrëveshjes me Greqinë

# Ndryshimi i kufijve, Meta: Cenon stabilitetin, në rrezik parimet e BE

## "Jo ndryshim të realitetit, devijimet pa dobi"


Presidenti i Republikës, Ilir Meta



**REFERENDUMI**
"U bëj thirrje të gjithë shqiptarëve të Maqedonisë që të marrin pjesë në referendumin e datës 30 shtator dhe të votojnë pro marrëveshjes, për të çelur një kapitull të ri jo vetëm në dobi të integrimit të Maqedonisë, por edhe në të mirë të ardhmes së tyre në këtë vend",-tha z.Meta.

**'KUFIJTË'**
"Dialogu Serbi-Kosovë është për të udhëhequr procesin e pranimit të realitetit, në emër të paqes e stabilitetit. Çdo debat që ndihmon në kuptimin dhe pranimin e këtij realiteti është i mirëpritur. Çdo devijim nga ky realitet, përveçse provokon emocione dhe retorika populiste nuk sjell dobi",-theksoi z.Meta.

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta reagoi dje për herë të parë për debatin mbi korrigjimin e kufijve mes Kosovës dhe Serbisë. Meta u shpreh kundër ndryshimit të kufijve, duke thënë se cenon stabilitetin dhe rrezikon parimet e BE. Në një intervistë për "Albanian Daily News" kreu i shtetit shqiptar tha se dialogu Serbi-Kosovë është ndërtuar jo për të ndryshuar realitetin. Meta tha se nuk duhet të cenohet sovraniteti i Kosovës, që tashmë është i njohur ndërkombëtarisht, ndërsa mbështeti qëndrimin e qeverisë shqiptare.

**Zoti President, kohët e fundit është hapur një debat i madh mbi ndryshimin e kufijve mes Serbisë dhe Kosovës, debat në të cilin janë përfshirë politikanë vendas dhe të huaj dhe shumë analistë. Cili është qëndrimi juaj lidhur me këtë debat?**
Dialogu Serbi-Kosovë është ndërtuar jo për të ndryshuar realitetin, por për të udhëhequr procesin e pranimit të tij, në emër të paqes e stabilitetit. Ai është parakusht për integrimin evropian të të dy vendeve. Çdo diskutim dhe debat që ndihmon në kuptimin dhe pranimin e këtij realiteti është i mirëpritur. Çdo devijim nga ky realitet, përveçse provokon emocione dhe retorika populiste nuk sjell dobi. Ballkani ka pësuar transformime të thella në dy dekadat e fundit në të cilat janë investuar seriozisht SHBA dhe BE-ja. Një nga investimet më të mëdha dhe të suksesshme ka qenë Pavarësia e Kosovës dhe në vijimësi vendosja e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë në dobi të normalizimit të marrëdhënieve dhe të stabilitetit, paqes dhe sigurisë afatgjate në rajon. E kaluara historike e Ballkanit është fatkeqësisht e lidhur me ndryshime kufijsh, spastrim etnik dhe shpërngulje të dhunshme të popullsive të cilat janë shoqëruar me probleme të mëdha, armiqësi, luftëra e urrejtje. Marrëveshja që mendohet të arrihet sot mes palëve është e rëndësishme të çlirojë energji pozitive, të ndihmojë frymën e bashkëjetesës dhe harmonisë dhe të shërojë ndjenjën e urrejtjes të mbjellë nga e kaluara dhe historia.

**Ju mendoni se historia po përsëritet, ky proces duket se është i mirëkoordinuar nga të dy palët?**
Është jetike që jo vetëm të mos rikthehen më kurrë pamje të shpërnguljes ose lëvizjes me dhunë të familjeve, qofshin këto serbe apo shqiptare, por edhe asnjë familje e vetme nuk duhet të mendojë shpërnguljen për shkak të pasigurisë që sjell debati i ndryshimit të kufijve.

**Cili është roli i Shqipërisë në këtë çështje të rëndësishme?**
Shqipëria gjithmonë ka qenë dhe mbetet një mbështetëse e fortë e procesit të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, të ndërmjetësuar nga BE dhe mbështetur nga SHBA dhe përfundimi i këtij dialogu duhet ta bëjë rajonin më të qetë dhe qytetarët tanë më të sigurtë për të ardhmen e tyre. Për Shqipërinë është i një rëndësie të veçantë respektimi i parimeve bazë të sanksionuar në Kartën e Helsinkit dhe të Parisit të OSBE për sigurinë në Europë, veçanërisht parimi i mos-ndryshimit të kufijve.

**Çfarë fiton Serbia nga kjo marrëveshje?**
Bashkimi Evropian me Strategjinë e re të Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor, u ka ofruar perspektivë të qartë integruese vendeve të këtij rajoni. Unë besoj se përmes një marrëveshjeje me Kosovën Serbia fiton të ardhmen e saj evropiane, pasi dihet se marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë kusht i domosdoshëm dhe i pashmangshëm për çdo vend të rajonit, përfshirë dhe Serbinë. Të mos harrojmë që në dokumentin hyrës të BE-së në janar të vitit 2014, kur u hapën negociatat me Serbinë theksohet se ky proces duhet të sigurojë që të dyja palët të ecin në rrugën e tyre evropiane, pa mundësinë që ta bllokojnë njëra-tjetrën në këtë përpjekje dhe kjo gradualisht duhet të çojë në një normalizim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. BE-ja dhe SHBA janë garant që përfundimi i kësaj marrëveshjeje i siguron Serbisë rrugën e saj drejt integrimit në BE. Autoritetet e larta serbe kanë deklaruar shpesh se anëtarësimi i vendit të tyre në BE është shumë i rëndësishëm dhe janë angazhuar seriozisht në këtë proces. Shtoj se ky përfitim është në të mirë e dobi jo vetëm të Serbisë, por edhe të serbëve që jetojnë në Kosovë, është në interes të të gjitha vendeve të rajonit.

**Presidenti i Kosovës Thaçi ka deklaruar disa herë se ndryshimi i kufijve do të jetë në të mirë të të ardhmes së Kosovës?**
Së pari, do të uroja për Kosovën të kishim një bashkim forcash dhe energjish që promovojnë dhe mbështesin në unison interesin më të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Kam vënë re se Presidenti Thaçi ka përsëritur rëndësinë e integritetit territorial të Kosovës, rëndësinë e multietnicitetit të saj dhe rëndësinë e stabilitetit të rajonit. Këto janë parime shumë të rëndësishme të cilat garantojnë një proces të pakthyeshëm dhe të qëndrueshëm.

**Si e shikoni ju të ardhmen e Kosovës?**
Sovraniteti dhe integriteti territorial i Kosovës është realitet i njohur dhe i pranuar tashmë nga një shumicë bindëse e vendeve anëtare të OKB-së. Kosova është sot anëtare e shumë organizatave ndërkombëtare dhe rajonale. Ajo është futur në një proces asociimi të Bashkimit Evropian dhe qytetarët tanë janë në pritje të lajmit të lëvizjes së lirë të qytetarëve të saj në vendet e Bashkimit Evropian. Shqipëria është krenare që ka kontribuar në këto arritje të rëndësishme dhe mbetet e vendosur në angazhimin e saj për anëtarësimin e plotë të Kosovës në OKB dhe në BE.

**Keni ndonjë koment ndaj intervistës së ministrit Bushati?**
Unë mbështes qëndrimin e qeverisë së Shqipërisë në përkrahje të përpjekjeve të qeverisë së Kosovës për ruajtjen e stabilitetit, integritetit territorial, karakterit multietnik të shtetit të Kosovës dhe garancive të rëndësishme ndërkombëtare, Plani Ahtisari e Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të Hagës, i cili legjitimoi të përputhshëm me të Drejtën Ndërkombëtare Pavarësinë e Kosovës.

**Bashkimi Europian ka qenë deri tani jo shumë i qartë lidhur me çështjen e kufijve. Mendimi juaj, zoti President?**
Modeli dhe parimet e bashkëjetesës, harmonisë dhe paqes mes vendeve të Bashkimit Europian është modeli i shkrirjes dhe zhdukjes së kufijve shtetërorë, veçanërisht atyre etnikë. Kështu e shikoj edhe unë procesin e integrimit të rajonit tonë në BE: drejt bërjes të parëndësishëm të kufijve dhe jo drejt imponimit të kufijve të rinj. Çdo tentativë për të imponuar modele të ndryshimit të kufijve, jo vetëm do të cenonte stabilitetin e rajonit, por do të vinte në rrezik edhe frymën dhe parimet e BE-së për të cilat ajo është investuar nga themelimi i saj deri sot.

**Më 30 shtator qeveria 'Zaev' do të organizojë referendumin lidhur me marrëveshjen e arritur me Greqinë për emrin e ardhshëm të saj, rezultati i të cilit është ende një dilemë. Sa i rëndësishëm është për Shqipërinë e rajonin ky rezultat?**
Integrimi i rajonit në BE dhe në NATO është një proces i rëndësishëm dhe jetik për të ardhmen e tij. Maqedonia ndodhet në një moment shumë të rëndësishëm, të favorshëm dhe optimist, pas një periudhe të gjatë stanjacioni në marrëdhëniet me Greqinë, me Bashkimin Evropian dhe me NATO-n. Pa asnjë mëdyshje ne kemi mbështetur dhe nxitur dialogun e drejtpërdrejtë mes Athinës e Shkupit me bindje të plotë se kjo është rruga më e mirë për të çuar përpara dhe për të gjetur zgjidhjen e duhur të procesit të tejzgjatur integrues të Maqedonisë. Marrëveshja e arritur me Greqinë për emrin hap një perspektivë të re, është një hap pozitiv i Maqedonisë drejt anëtarësimit të saj në NATO, integrimit në BE dhe ndikon drejtpërdrejt në paqen, sigurinë dhe stabilitetin e rajonit tonë.

Faktori politik shqiptar në Maqedoni ka një rol të pazëvendësueshëm si në procesin e ndryshimeve të brendshme e kohezionit politik e social ashtu edhe në procesin euroatlantik të Maqedonisë. Ai ka sërish mundësinë të rikonfirmojë qëndrimin e palëkundur të tij pro anëtarësimit të Maqedonisë në NATO dhe në BE duke u angazhuar seriozisht dhe me të gjitha energjitë për suksesin e referendumit. Suksesi i këtij referendumi është një fitore e forcave dhe frymës integruese, europianiste dhe euroatlantike kundrejt tendencave arkaike, anti-europiane dhe anti-NATO jo vetëm në Maqedoni, por në të gjithë rajonin tonë. Ndaj besoj e njëkohësisht u bëj thirrje të gjithë shqiptarëve të Maqedonisë që të marrin pjesë në referendumin e datës 30 shtator dhe të votojnë pro marrëveshjes, për të çelur një kapitull të ri jo vetëm në dobi të integrimit të Maqedonisë, por edhe në të mirë të ardhmes së tyre në këtë vend.

Ja kur dëmshpërblimi financiar për ish-të përndjekurit mund t'i kalojë shtetit

# Ish-të përndjekurit, ndryshon skema për pagesën e kësteve

## *Projektligji, fondi do të ndahet në mënyrë proporcionale*

Ornela Manjani

Qeveria ndryshon ligjin për pagesën e dëmshpërblimit për ish-të përndjekurit politikë. Ndryshimi parashikon që fondi që do të vihet në dispozicion nga buxheti i shtetit do të ndahet në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit, dhe jo si deri tani që fondi ndahej 70 % për kategorinë parësore dhe 30 % për trashëgimtarët. Në projektligjin që është miratuar në qeveri dhe do të kalojë për shqyrtim e votim në parlament thuhet se "Në nenin 12 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon: Paragrafi i parë ndryshon me këtë përmbajtje: "Në bazë të buxhetit vjetor të vënë në dispozicion, fondi i dëmshpërblimit të ish-të dënuarve politikë nga regjimi komunist do të ndahet në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit, me kusht që kësti i dëmshpërblimit të mos jetë më i madh se 1 milion lekë. Për të gjitha subjektet përfituese parësore, kur vlera totale e dëmshpërblimit është mbi 8 milionë lekë, do të vijohet me pagesën e këstit pasardhës deri në shpërndarjen e plotë të shumës së miratuar. Në rast se vlera totale e miratuar për të gjithë përfituesit është deri në 1 000 000 lekë, shpërndarja e dëmshpërblimit do të kryhet me një këst të vetëm, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet shpërndarja e dëmshpërblimit". Ndryshimet në ligj parashikojnë që me kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit, për të gjithë përfituesit, brenda këstit më të ulët, fillon pagesa e këstit pasardhës. Ky mekanizëm do të përsëritet deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit".

**DËMSHPËRBLIMI I KALON BUXHETIT**

Në rastin kur e drejta e përfitimit të dëmshpërblimit financiar përfundon me mbylljen e rrethit të familjarëve që nuk jetojnë, të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, dëmshpërblimi financiar, për pjesën takuese të tyre, kalon në buxhetin e shtetit. Qeveria ka miratuar edhe ndryshimin e në nenin 29, pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi i tretë me këtë përmbajtje: "Gabimet e bëra në të dhëna ose në llogaritjen e masës së shpërblimit, ose ndonjë pasaktësi e dukshme në vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e dëmshpërblimit financiar, mund të rishikohen me vendim të Këshillit të Ministrave".

**PËRFITOJNË DËMSHPËRBLIM**

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i përfituesve, masës, kritereve dhe procedurës së përfitimit të dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politikë, të cilët kanë vuajtur persekutimin e drejtpërdrejtë në regjimin komunist, nëpërmjet kryerjes së dënimeve penale të padrejta, si burgim apo masa mjekësore të detyrueshme, si pasojë e një apo disa vendimeve penale të formës së prerë të gjykatave të zakonshme, gjykatave speciale apo të urdhrave të organeve të hetuesisë, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991.

Objekt i këtij ligji është edhe dëmshpërblimi i familjarëve të viktimave, të ekzekutuara padrejtësisht për motive politike, me vendime penale të formës së prerë të gjykatave të zakonshme apo speciale, ose me urdhra të organeve të hetuesisë, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991, si dhe dëmshpërblimi financiar për personat e internuar ose të dëbuar, me kusht që humbja e jetës apo periudha e vuajtjes së internimit ose dëbimit të vërtetohen me dokument, të krijuar si burim arkivor para datës 1.10.1991. Dëmshpërblimi i viktimave, të vrara ose të ekzekutuara gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991, jepet vetëm për familjarët e tyre, sipas këtij ligji. Qëllimi i këtij ligji është dhënia e dëmshpërblimit financiar nga shteti shqiptar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, për familjarët e viktimave të ekzekutuara dhe personat e internuar ose të dëbuar në kampe, si një angazhim i shtetit demokratik në dënimin e krimeve të regjimit totalitar komunist dhe garantimin për ta të një jete më të mirë. Dëmshpërblimi financiar, sipas këtij ligji, nuk përjashton marrjen e masave të tjera, të njëkohshme ose të mëvonshme, ligjore apo administrative, në dobi të të persekutuarve e të dënuarve politikë, të cilat i shërbejnë rivendosjes së drejtësisë dhe dinjitetit shoqëror të kësaj shtrese apo krijimit të kushteve favorizuese, për riintegrimin shoqëror të tyre. Procedura e shqyrtimit administrativ të kërkesave dhe masa e dëmshpërblimit financiar për familjarët e viktimave të ekzekutuara padrejtësisht pa gjyq, për motive politike, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 01.10.1991, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.



### Dëmshpërblimi për familjarët e të dënuarve me dënim kapital



Familjarët e viktimave, të pushkatuara apo të ekzekutuara me dënim politik të padrejtë, për vuajtjen dhe persekucionin, përfitojnë një dëmshpërblim financiar të barabartë, gjithsej, në masën e 8 viteve kompensim dënimi me burgim. E drejta e familjarëve për të kërkuar dëmshpërblim është e drejtë jopasurore vetjake.

### MASA E DËMSHPËRBLIMIT

**Masa e dëmshpërblimit për të burgosurit, të internuarit ose të dëbuarit politikë do të jetë si më poshtë:**

➤çdo i dënuar politik, për çdo ditë vuajtjeje dënimi të kryer, në burg, spital psikiatrik, spital burgu, izolim në hetuesi, nga data 30.11.1944 deri më 1.10.1991, dëmshpërblehet financiarisht, sipas kritereve të këtij ligji, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në ditë;

➤ për personat që kanë vuajtur internim në kamp me rrethim me tela me gjemba deri në vitin 1954, masa e dëmshpërblimit është 1 000 (një mijë) lekë në ditë;

➤ për personat e tjerë të internuar ose të dëbuar parashikohet një skemë pensioni, e cila do të rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Dëmshpërblimi i përcaktuar në paragrafin më sipër u takon dhe familjarëve të tij, në pjesë të barabarta takuese, kur i dënuari nuk jeton më. E drejta e familjarëve për të kërkuar dëmshpërblim është e drejtë jopasurore vetjake. Nga shuma që çdo i dënuar politik përfiton nga ky ligj, zbritet masa e dëmshpërblimit që ai ka përfituar me ligjet e mëparshme.

### NDRYSHIMET NË LIGJIN PËR PAGESAT E DËMSHPËRBLIMEVE

**Ishte**

♦Kriteret për shpërndarjen e fondit (ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)
Në bazë të buxhetit vjetor, të vënë në dispozicion dhe sipas radhës së caktimit të dëmshpërblimit, fondet do të ndahen në mënyrë proporcionale për të gjithë ish të dënuarit dhe familjarët e viktimave të pushkatuara, me kusht që vlera e dëmshpërblimit gjatë fazës së parë të mos jetë më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.
I njëjti mekanizëm do të përsëritet një ose më shumë herë, deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit për të gjithë ish të dënuarit/familjarët e viktimave, me kusht që, në çdo rast, pjesa takuese që kompensohet të mos jetë më e vogël se 100 000 (njëqind mijë) lekë. Asnjë ish i dënuar apo familjar i tij nuk mund të dëmshpërblehet jashtë këtij mekanizmi.

**Bëhet**

**Neni 12**

Në nenin 12 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:
Paragrafi i parë ndryshon me këtë përmbajtje:
"Në bazë të buxhetit vjetor të vënë në dispozicion, fondi i dëmshpërblimit të ish-të dënuarve politikë nga regjimi komunist do të ndahet në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit, me kusht që kësti i dëmshpërblimit të mos jetë më i madh se 1 000 000 (një milion) lekë. Për të gjitha subjektet përfituese parësore, kur vlera totale e dëmshpërblimit është mbi 8 000 000 (tetë milionë) lekë, do të vijohet me pagesën e këstit pasardhës deri në shpërndarjen e plotë të shumës së miratuar. Në rast se vlera totale e miratuar për të gjithë përfituesit është deri në 1 000 000 (një milion) lekë, shpërndarja e dëmshpërblimit do të kryhet me një këst të vetëm, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet shpërndarja e dëmshpërblimit.".
Paragrafi i katërt ndryshon me këtë përmbajtje:
"Me kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit, për të gjithë përfituesit, brenda këstit më të ulët, fillon pagesa e këstit pasardhës. Ky mekanizëm do të përsëritet deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit.".

**Ishte**

**Neni 13 pika 3**

3. Ministri i Financave urdhëron shpërndarjen e dëmshpërblimit, sipas radhës së përparësisë së caktuar në nenin 12 të këtij ligji.
Bëhet
Në nenin 13, paragrafi i tretë ndryshon me këtë përmbajtje:
"Ministri përgjegjës për Financat urdhëron shpërndarjen e dëmshpërblimit, sipas nenit 12 të këtij ligji.".

**Ishte**

**Neni 29**

Miratimi i kërkesës
Ministri i Drejtësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, vendos miratimin apo refuzimin e kërkesës, i cili është i formës së prerë.
Brenda 10 ditëve, ministri i Drejtësisë paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave propozimet për përfitimin e dëmshpërblimit, sipas këtij ligji, të cilave u bashkëlidhen relacionet përkatëse.

**Bëhet**

**Neni 29**

Në nenin 29, pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi i tretë me këtë përmbajtje:
"Gabimet e bëra në të dhëna ose në llogaritjen e masës së shpërblimit, ose ndonjë pasaktësi e dukshme në vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e dëmshpërblimit financiar, mund të rishikohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".



### Fondi Monetar Ndërkombëtar ofron asistencë

## FMN e gatshme të ndihmojë administratën tatimore

Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Tatimeve Xhavit Çurri, priti në një takim drejtues të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të cilët ndodhen për një vizitë një javore në vendin tonë. Misioni i FMN-së i kryesuar nga z.Stephen Vesperman dhe Allan Jensen, vlerësuan performancën e deritanishme të administratës tatimore, rezultatet e arritura, si dhe përpjekjet që po bëhen për të rritur bazën e tatimpaguesve, si dhe cilësinë e shërbimit. Gjatë takimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, u bë një përditësim i rekomandimeve të lëna pas përfundimit të marrëveshjes. Ekspertët theksuan se administrata tatimore ka bërë progres të dukshëm gjatë kësaj periudhe. Misioni i FMN-së u shpreh i gatshëm që të vazhdojë të ndihmojë administratën tatimore për të përmirësuar cilësinë e kontrolleve, si dhe rritjen profesionale të burimeve njerëzore. Nga ana e tij zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Tatimeve Xhavit Çurri, i njohu ekspertët me reformat që po ndërmerr administrata tatimore, me projektet kryesore që janë duke u zbatuar, siç është fiskalizimi, por edhe rritja e numrit të pagesave elektronike, si një mënyrë për të reduktuar kontaktet e tatimpaguesve me administratën tatimore, por edhe për të kursyer kohë e para.

### Të mos shkosh te doktori dhe dentisti për të kursyer para, shqiptarët të parët në Europë

# Raporti, 41 % e shqiptarëve kursejnë paratë për të te doktori e dentisti

## *Gjysma e të anketuarve nuk kanë shkuar fare te stomatologu*

Rreth 41% e shqiptarëve kanë shtyrë vizitën ose nuk kanë shkuar fare te mjeku për të kursyer, përqindja më e lartë në të gjithë Europën. Situata është më keq për sa i përket kujdesit ndaj dhëmbëve, gjysma e të anketuarve në Shqipëri janë përgjigjur se nuk kanë shkuar fare ose kanë vonuar një vizitën te dentisti. Të dhënat janë publikuar në Anketën e Cilësisë së Jetës të kryer nga Komisioni Europian. Edhe në raport me vendet e tjera fqinje, të cilat janë kandidate për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian, diferenca është e lartë. Pas Shqipërisë, të anketuarit në Maqedoni dhe në Mal të Zi, të cilët nuk kanë shkuar te doktori për të kursyer janë 25% e të pyeturve. Ndërsa në Serbi, 22% e të pyeturve kanë deklaruar se nuk kanë shkuar te mjeku për të kursyer. Nder vendet kandidate, Turqia ka përqindjen më të ulët, ku 19% e të pyeturve kanë pohuar. Kush ka më pak të ardhura, lë shëndetin të fundit. Thonë se para shëndetit, paraja nuk ka rëndësi. Megjithatë 70% e individëve me të ardhura të ulëta në Shqipëri heqin dorë nga vizitat nga mjeku për të kursyer.

**ANKETA**

Në Anketën e Cilësisë së Jetës, të anketuarit janë grupuar në katër kategori (nga 1 në 4) referuar të ardhurave të tyre, ku Grupi 1 janë individët me të ardhura më të ulëta dhe grupi 4, individët me të ardhura më të larta. Në vendet e rajonit, përqindja e individëve më të ardhura të ulëta që nuk kanë shkuar te mjeku për të kursyer është shumë më e ulët, ndërsa në Malin e Zi, përqindja është edhe më e ulët se sa tek individët me të ardhura të larta. Sipas Anketës së Cilësisë së jetës, vetëm 12% e individëve me të ardhura të ulëta në Malin e Zi nuk kanë shkuar te mjeku për të kursyer para. Në Maqedoni, vetëm 34% e të pyeturve e grupit me të ardhura më të ulëta deklaruan se nuk shkuan te mjeku për të kursyer, 39% në Serbi dhe 29 në Turqi. Ndërsa për sa i përket individëve që i përkasin grupit të katër të të ardhurave, Shqipëria ka përqindjen më të ulët. Vetëm 12 për qind e individëve me të ardhura të larta nuk shkuan te mjeku për të kursyer. Në vendet e tjera kandidate për t'u anëtarësuar në BE, përqindja e individëve më të ardhura të larta që nuk shkuan te mjeku për të kursyer para varion nga 20-25%.







**KURSIMI TE USHQIMI**

Në një ekonomi të konsumit, duket e çuditshme të kursyerit tek ushqimet. Megjithatë, për 38% e shqiptarëve të pyetur në anketën e cilësisë së jetës së Komisionit Europian, thanë se kanë blerë më pak fruta dhe perime për të kursyer para dhe 46% e tyre kishin blerë më pak mish nga se iu nevojitej për të njëjtën arsye. Përqindja e të anketuarve që iu janë përgjigjur me po pyetjes nëse kanë blerë më pak perime dhe fruta, por edhe mish, është më e larta në Shqipëri nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Europian, por edhe nga vendet kandidate për tu anëtarësuar. Në krahasim me vendet e rajonit, diferenca është e konsiderueshme. Pas Shqipërisë renditet Maqedonia, ku vetëm 28% e të anketuarve u përgjigjën se kanë blerë më pak perime dhe fruta që të kursejnë para, dhe 35% e tyre pohuan se kursyen tek racioni i mishit. Në Malin e Zi dhe në Serbi, përqindja e të anketuarve që thanë se kursyen tek blerja e frutave dhe perimeve është përkatësisht 15-16%.

### Riparime urgjente në autostradën Tiranë-Elbasan

## Qeveria merr 16 mln dollarë hua nga OPEC

Këshilli i Ministrave ka miratuar në mbledhjen e fundit marrëveshjen e huas mes Shqipërisë dhe Fondit të OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar. Vlera e marrëveshjes, së miratuar në parim dhe që pret aprovimin e Kuvendit në shtator, kap shifrën e 16 milionë dollarëve amerikanë. Sipas vendimit të qeverisë, kjo shumë do të përdoret për të financuar punimet për riparime emergjente në autostradën Tiranë-Elbasan. Në një vlerësim të fundit të Korrikut, ARRSH llogarit se vetëm lirimi dhe



stabilizimi i rrëshqitjeve të ndodhura në muajin dhjetor 2017 në këtë aks do të kushtojnë rreth 374 milionë lekë, apo rreth 3.4 milionë dollarë. Ndërkohë, tenderi për fazën e parë të këtyre punime është hapur dhe pritet që lirimi i segmentit të bllokuar të ndodhë në fillim të vitit të ardhshëm. Sa i takon pjesës tjetër të fondit prej 16 milionë dollarësh, ai mund të përdoret për të përfunduar punimet e tjera të nevojshme të kësaj autostrade.

## Industria përpunuese më përfituesja, punësohen mbi 5 mijë persona

Rreth 668 biznese kanë përfituar fonde për nxitjen e punësimit gjatë vitit që lamë pas, nga të cilët 227 janë aplikime të vitit të mëparshëm, dhe 441 janë projekte të reja. Ndërsa janë punësuar, trajnuar përmes punës dhe kanë kryer praktikat profesionale 5264 punëkërkues të papunë nga ky program, me anë të të cilit Shërbimi Kombëtar i Punësimit vuri në dispozicion një fond prej 490 milionë lekësh. Por si janë shpërndarë fondet? Sipas të dhënave zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, numri më i madhi subjekteve përfituese dhe punonjësve përfitues ka qenë në Tiranë, ku janë mbështetur me fonde 99 subjekte dhe janë punësuar 1370 persona, ndërsa



numri më i ulët i bizneseve përfituese regjistrohet në Berat, vetëm 24 subjekte. Sa i përket fushës ku ato operojnë, pjesa më e madhe e fondeve ka shkuar për industrinë përpunuese, me 27 për qind, e ndjekur nga tregtia me shumicë dhe pakicë si dhe riparim automjetesh dhe motoçikletash me 14 për qind. Ndërsa sektori i arsimit, shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale kanë qenë më pak të mbështetura, përkatësisht me 4 dhe 6 për qind.

# REGJISTRIMET NË UNIVERSITETE
## INTERVISTA

Rektori i UT-së zbardh udhëzimin: Do të vazhdojmë të jemi të akredituar

# Mynyr Koni: Rreth 18 mijë maturantë aplikuan në Universitetin e Tiranës

## "Regjistrimet, ku duhet të kenë kujdes fituesit"

Voltiza Duro

Rreth 18 mijë maturantë në mbarë vendin kanë aplikuar në një prej programeve të studimit pranë Universitetit të Tiranës, për vitin e ri akademik 2018-2019. Ndërkohë, sot fillon procesi i regjistrimit për të gjithë fituesit që do të zgjasë deri në 12 shtator. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare" rektori i Universitetit të Tiranës, Mynyr Koni tregon se dega më e parapëlqyer për maturantët në këtë institucion të arsimit të lartë është juridiku me plot 6500 aplikime nga 700 kuota që ka në total ky program. Më tej, Koni sqaron për të gjithë fituesit procesin e regjistrimit pranë sekretarive mësimore dhe thekson se maturantët që kanë bërë ankimime ditën e djeshme, duhet të regjistrohen në një program që janë shpallur fitues. Rektori i UT-së sqaron opinionin publik edhe në lidhje me çështjen e akreditimit, ku sipas tij ky universitet ka plotësuar pothuajse të gjitha detyrat e caktuara nga MASR. Sipas udhëzimit që Koni zbardh për 'Gazeta Shqiptare', universiteti i Tiranës do të vazhdojë të jetë i akredituar edhe gjatë dy periudhave të akreditimit.

**Sa është numri i aplikimeve gjatë raundit të parë në Universitetin e Tiranës për vitin e ri akademik 2018-2019?**

Për vitin e ri akademik 2018-2019 në Universitetin e Tiranës kemi pasur rreth 80 mijë aplikime. Sigurisht që numri i aplikimeve është shumë i lartë në pamje të parë, por kjo ndodh pasi studenti mund të aplikojë në 10 degë. Por në total, rezultojnë rreth 18 mijë maturantë që kanë aplikuar në UT në programet e studimit përkatës, që është një shifër shumë e lartë. Kjo tregon që interesi i maturantëve për të studiuar në këtë universitet është shumë i lartë.

**Cilat janë disa prej programeve të studimit më të parapëlqyera nga maturantët këtë vit?**

Në raport me kuotat e miratuara, degët e parapëlqyera në Universitetin e Tiranës duke iu referuar numrit të aplikimeve, vazhdon të jetë programi i drejtësisë me 6500 aplikime në total. Më tej ndër të parapëlqyerat e maturantëve janë programet e studimit pranë Fakultetit Ekonomik si dega Administrim Biznes. Gjithashtu, edhe për programet e studimit në Fakultetin e Shkencave Sociale, Fakultetin e Histori-Filologjisë dhe Shkencat e Natyrës ka pasur interes nga maturantët. Pra, konstatojmë se ka interes, normalisht jo të gjithë kanë të njëjtin intensitet aplikimesh, por përgjithësisht degët e UT-së janë të kërkuara nga maturantët dhe unë i ftoj që nesër (sot) me fillimet e regjistrimeve të paraqiten dhe të bëhen pjesë e programeve të studimit. Mos të shqetësohen, por thjesht të presin radhën për regjistrim.

**Nesër (sot) fillojnë regjistrimet për të gjithë maturantët që janë shpallur fitues. Si do të vijojë ky proces në Universitetin e Tiranës? Çfarë procedure duhet të ndjekin fituesit?**

Procedura e regjistrimit është pothuajse njësoj me vitin e kaluar, me ndryshime të vogla që nuk cenojnë parimin e përgjithshëm të procedurës së regjistrimit. Ne kemi paraqitur renditjen e listës së aplikantëve për çdo program studimi, që janë vënë në dispozicion edhe në portalin u-albania (portali ku do të regjistrohen studentët). Gjithashtu, listat e renditjes janë vënë në dispozicion edhe për Qendrën e Shërbimeve Universitare. Sot (dje) pasi kandidatët për studentë që janë informuar për rezultatin e tyre, mund të vijojnë me procedurën e ankimimit mbi vlerësimin e tyre, e po në datën 29 gusht do të merren në administrim dhe do të merret vendimi.

> Në raport me kuotat e miratuara, degët e parapëlqyera në Universitetin e Tiranës duke iu referuar numrit të aplikimeve, vazhdon të jetë programi i drejtësisë me 6500 aplikime në total. Më tej ndër të parapëlqyerat e maturantëve janë programet e studimit pranë Fakultetit Ekonomik si dega Administrim Biznes. Gjithashtu, edhe për programet e studimit në Fakultetin e Shkencave Sociale, Fakultetin e Histori-Filologjisë dhe Shkencat e Natyrës ka pasur interes nga maturantët.


Rektori i Universitetit të Tiranës Mynyr Koni

Regjistrimet fillojnë nesër (sot) dhe maturantët duhet të paraqiten me dokumentacionin përkatës pranë sekretarive mësimore të fakulteteve që janë shpallur fitues. Gjithashtu, maturantët duhet të kenë kujdes dhe të kontrollojnë në portalin u-albania lëvizjen e vijës së kuqe dhe në fazën paraardhëse aplikanti njoftohet paraprakisht që është shpallur fitues në një prej degëve ku ka aplikuar.

**A duhet të regjistrohen maturantët që kanë bërë ankimim për degën e parapëlqyer në të cilën nuk janë shpallur fitues?**

Dua të sqaroj maturantët, që pavarësisht nga përgjigjja e vendimit për ankimimin përkatës, maturanti duhet të regjistrohet në programin që është shpallur fitues brenda periudhës 30 gusht deri në 12 shtator të këtij viti që janë 7 fazat e raundit të parë. Nëse nuk regjistrohen, këta maturantë humbasin të drejtën në fazën përkatëse dhe më pas vendimit mbi ankimimin, mund të humbë të drejtën mbi degën që ai ka të preferuar. Nëse ankimimi shpallet pozitiv, atëherë atij i lind e drejta që në fund të raundit të parë, pra në 13 shtator të çregjistrohet dhe regjistrohet në programin përkatës që i është njohur si i tillë pas ankimimit.

**Cili është dokumentacioni që duhet të paraqesin fituesit pranë sekretarive mësimore?**

Maturantët fitues duhet të paraqesin pranë sekretarive mësimore personalisht, (ose në mungesë të tyre përfaqësuesin e autorizuar me prokurë) këto dokumente: mjetin e identifikimi dhe një fotokopje të saj; fotokopje të noterizuar të diplomës së maturës shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë; si dhe certifikatën e notave. Gjithashtu, fituesit duhet të plotësojnë edhe një deklaratë që e gjejnë pranë sekretarive mësimore. Kështu përfundon procesi i regjistrimit.

**Po nëse maturantët dëshirojnë një program studimi, por janë regjistruar ndërkohë në një tjetër, kur mund të çregjistrohen për të aplikuar sërish?**

Në datën 13 shtator, sipas udhëzimit, si thashë edhe më lart, mund të çregjistrohen maturantët që kanë bërë ankime duke paraqitur një kërkesë e të tërheqë dokumentacionin nga fakulteti. Nëse nuk çregjistrohet brenda 13 shtatorit ai nuk ka më të drejtë të ndryshojë programin e studimit për këtë vit akademik. Pas kësaj fillon raundi i dytë, dhe studenti i çregjistruar mund të riaplikojë sërish nga e para në degët që dëshiron.

**Rreth një vit më parë, sipas raportit të agjencisë britanike, Universiteti i Tiranës është vlerësuar vetëm me një vit akreditimi. Ministria e Arsimit ka caktuar disa detyra që UT duhet t'i plotësojë brenda një viti. Sa prej tyre janë plotësuar deri më tani?**

Është shumë e rëndësishme çështja e akreditimit të Universitetit të Tiranës dhe është një moment shumë i mirë për të dhënë një sqarim për opinionin publik dhe maturantët. Dua t'iu bëj thirrje të gjithë studentëve që të jenë të qetë mbi akreditimin e UT-së. Dua të theksoj se akreditimi që është bërë vjet është akreditim institucional dhe jo akreditim i programeve të studimit, pra është një akreditim mbi dokumentacionin përkatës. Ndërkohë për t'i parapririë këtij procesi bordi i akreditimit ka dhënë shumë i mirë për të universitetin për të cilat është bërë një plan veprimi që në mbledhjen e senatit në nëntor të 2017-ës. Hap pas hapi, janë realizuar pothuajse të gjitha detyrat e dhëna. Njëkohësisht Universiteti i Tiranës, në dhjetor të 2017-ës, ka aplikuar për riakreditim ose akreditim periodik të universitetit. Gjatë kësaj periudhe është bërë një punë e palodhur nga të gjitha strukturat ku në mesin e korrikut është dorëzuar dhe raporti përfundimtar i grupit të vlerësimit institucional të brendshëm me gjithë dokumentacionin përkatës. Tashmë na ka mbërritur axhenda e grupit të vlerësimit të jashtëm ku brenda muajit shtator shpresojmë të vijë draft raporti i grupit të vlerësimit të jashtëm. Dua të theksoj për maturantët se nuk ka asnjë problem për afatin kohor për të cilën thuhet se afati i akreditimit është deri në shtator. Në një vendim të veçantë bordi i akreditimit vendosi se Universiteti i Tiranës do të konsiderohet i akredituar edhe mes dy periudhave të akreditimeve.

**REGJISTRIMI**

Procedura e regjistrimit është pothuajse njësoj me vitin e kaluar, me ndryshime të vogla që nuk cenojnë parimin e përgjithshëm të procedurës së regjistrimit. Ne kemi paraqitur renditjen e listës së aplikantëve për çdo program studimi, që janë vënë në dispozicion edhe në portalin u-albania (portali ku do të regjistrohen studentët).

Merita Molla: E thirrën o Gon, o Gon, doli nga shtëpia më 23 gusht dhe nuk e pashë më

# Zhduken dajë e nip në Shkodër, flet gruaja e Gëzim Hysaj: Iku të takojë një shok e nuk u kthye

## Saimira Hysaj: I kërkoj shtetit që të gjendet im shoq

Senad Nikshiqi

Prej 6 ditësh Gëzim Hysaj banues në njësinë Postribë në Shkodër dhe Agron Mollaj banues në fshatin Dobraç të njësisë Rrethina janë zhdukur pa lënë asnjë gjurmë. Gëzimi është daja i Agronit dhe që të dy kanë humbur kontaktet me familjet mbrëmjen e 23 gushtit. Ata kanë dalë nga banesat e tyre në Postribë dhe Dobraç për të takuar secili nga një person të paidentifikuar për familjarët dhe nuk janë kthyer më. Të dy familjet nuk kanë asnjë ide se ku ndodhen 56 vjeçari Gëzim Hysaj dhe 47 vjeçari Agron Mollaj. Pasi kanë kuptuar se diçka nuk shkon dhe këta dy persona nuk janë kthyer në banesat e tyre bashkëshortet kanë bërë një kallëzim në policinë vendore të Shkodrës. Forcat e policisë janë vënë në kërkim, por deri tani nuk kanë rënë në gjurmët e dy shtetasve dajë dhe nip. Bashkëshortja e Gëzim Hysaj, Saimira Hysaj dhe bashkëshortja e Agron Mollaj, Merita Mollaj në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" kanë rrëfyer se si janë larguar këta dy persona nga banesat me 23 gusht dhe se si pas një ore telefoni i Gëzim ka dalë i fikur ndërsa Agron Mollaj nuk kishte fare telefonin me vete dhe që atëherë nuk kanë asnjë ide se ku ndodhen këta dy shtetas. Saimira dhe Merita kanë një apel për të gjithë dhe kërkojnë që policia të gjejë bashkëshortët ose të gjithë ata që kanë informacione t'i ndihmojnë. Gëzim Hysaj është baba i katër fëmijëve ndërsa është një punëtor i thjeshtë në bujqësi dhe në një punishte ari dhe sermi në Shkodër. Nipi i tij Agron Mollaj është baba i tre fëmijëve ndërsa punonte me një servis motorësh te shtëpia e tij. Kjo ngjarje për mënyrën se si ka ndodhur ngjan si kriminale edhe pse dy familjet dhe policia deri më tani nuk kanë asnjë pistë hetimi dhe gjithçka është mister.



Merita Molla



Gëzim Hysaj



Saimira Hysaj

**INTERVISTA ME SAIMIRA HYSAJ**

**Çfarë ka ndodhur me bashkëshortin tuaj?**

Me datë 23 burri im ka dalë nga shtëpia për të takuar një shok. Që atëherë nuk kam asnjë të dhënë për të. I kërkojmë shtetit, policisë, mediave dhe të gjithë njerëzve që nëse dinë diçka për vendndodhjen e tij të na tregojnë. Prej 6 ditësh nuk dimë asgjë për të. Kemi shkuar në polici dhe policia na ka thënë që jemi në kërkim e sipër dhe na kanë mbajtur me shpresa deri tani. 6 ditë për ne si familje janë shumë përderisa ai nuk ka bërë as ndonjë krim, asnjë ngatërresë apo asgjë të keqe ndaj ne duam që të gjendet.

**Keni një ide se çfarë mund të ketë ndodhur ose kush e ka marrë apo ku ka shkuar?**

Nuk di asgjë. Vetëm se di që ka dalë nga shtëpia atë natë në ora 20:20 të darkës dhe deri në orën 21:20 e ka pasur telefonin e ndezur. Më pas që nga ajo orë telefoni ka dalë i fikur dhe nuk kemi pasur asnjë komunikim me të dhe nuk dimë asgjë. I kam bërë një herë zile, por nuk e ka hapur telefonin. E kam marrë pas 5 minutash, por telefoni ka dalë i fikur dhe që aty nuk kemi asnjë ide dhe s'kemi asnjë kontakt. Kudo që të jetë ne duam që ai të gjendet, kjo është e vetmja gjë që kërkojmë.

**Kë shkoi për të takuar?**

Më ka thënë se do të takonte një shok të tijin në Shkodër, sepse ai i kishte kërkuar të pinte kafe. Vetëm kaq di.

Burri juaj ka humbur bashkë me nipin e tij apo jo?

Nipi i tij ka dalë nga banesa sipas familjarëve të tij rreth 21:30, pra pas një ore dhe nuk dimë gjë as për burrin dhe as për nipin. As ai nuk ka lënë një adresë të saktë, por vetëm dinë se e ka thirrur dikush për ta takuar dhe asgjë më tepër. Nuk janë në dijeni as ata dhe as ne se çfarë ka ndodhur. Kushdo që ta njohë burrin tim i lutem që të na tregojnë se ku ndodhen.

**Ka pasur ndonjë problem burri juaj, keni ndonjë dyshim pse ka ndodhur?**

Nuk ka pasur asnjë problem. Unë si bashkëshorte dhe fëmijët e mi nuk janë në dijeni të ndonjë problemi të bashkëshortit. Ka shkuar në Shkodër për të punuar si çdo familjar për të fituar bukën e gojës dhe si gjithë njerëzit e rregullt. Nuk ka pasur asnjë konflikt me kënd apo asgjë të tillë që ne mund të mendojmë apo dyshojmë.

**Çfarë punon burri juaj?**

Ai ka punuar edhe këtu tek shtëpia me bujqësi, por ka punuar edhe në Shkodër me një argjendar sa për të fituar bukën e gojës në një dyqan të vogël.

**Çfarë jetese keni në familjen tuaj?**

As mirë as keq, kemi një jetesë mesatare.

**Sa fëmijë keni ju?**

Unë kam tri vajza dhe një djalë.

Keni bërë tentativa me familjarë, të njohur apo shokë për ta gjetur?

Jo nuk e di askush se ku ndodhet, as familjarët, as të njohur dhe as shokët.

**Ka shfaqur ndonjë shqetësim kohët e fundit, mund të jetë shfaqur i shqetësuar?**

Jo, jo. Asnjëherë. Ka qenë shumë i qetë. Unë si

> "Nuk e kam asnjë ide se përse ka ndodhur dhe se çfarë ka ndodhur. Bashkëshorti im nuk kishte asnjë lloj problemi me askënd, as ndonjë shqetësim nuk më ka shfaqur kohët e fundit ndaj për ne është paimagjinueshme se si kanë kaluar 6 ditë dhe s'kemi asnjë lloj informacioni apo kontakti",-shprehet bashkëshortja e Agron Mollaj.

bashkëshorte nuk e kam parë të shqetësuar. Nuk kam arsye përse ka ndodhur, por vetëm dimë që ka dalë nga shtëpia në ora 20:20 me 23 dhe që atëherë nuk e dimë se ku ndodhet.

**Cili është mesazhi juaj pas gjithë kësaj që ka ndodhur?**

Ne i kërkojmë shtetit që të gjendet burri im sepse derisa ta gjejnë ne nuk jemi të qetë. Sido që të jetë puna dhe çfarë do që të ketë ndodhur, ne duam që ta gjejnë.

> **SAIMIRA HYSAJ**
> "Di që ka dalë nga shtëpia atë natë në ora 20:20 të darkës dhe deri në orën 21:20 e ka pasur telefonin e ndezur. Më pas që nga ajo orë telefoni ka dalë i fikur dhe nuk kemi pasur asnjë komunikim me të dhe nuk dimë asgjë. I kam bërë një herë zile, por nuk e ka hapur telefonin. E kam marrë pas 5 minutash, por telefoni ka dalë i fikur dhe që aty nuk kemi asnjë ide dhe s'kemi asnjë kontakt. Kudo që të jetë ne duam që ai të gjendet, kjo është e vetmja gjë që kërkojmë",-tregon gruaja e Gëzim Hysaj.

**INTERVISTA ME MERITA MOLLAJ**

**Çfarë ka ndodhur me bashkëshortin tuaj?**

Ka qenë ora rreth 21:30 e 23 gushtit dhe bashkëshortin e thirri një person nga dera e oborrit të shtëpisë. Ai doli dhe mendova se do kthehej. Që atë natë nuk është kthyer dhe nuk e dimë se ku ndodhet as se çfarë i ka ndodhur.

**Ju tha se kë po takonte?**

Jo nuk më tha se kë do të takonte.

**Personin që e thirri e njohët nga zëri se kush mund të ketë qenë?**

Jo, nuk e kam njohur as nga zëri se kush ishte.

**Në momentin që doli bashkëshorti juaj, ju ku ishit?**

Unë kam qenë brenda në shtëpi, sepse kisha vajzën të sëmurë dhe po qëndroja me atë ndaj nuk dola që të shihja se kush mund të ishte.

**Pasi ka dalë nga shtëpia keni kontaktuar atë natë përmes telefonit të Agronit?**

Jo nuk kam kontaktuar, sepse telefonin e la në shtëpi, sepse thjeshtë doli për të takuar atë personin. Agroni ka dalë me rroba shtëpie ashtu siç ishte.

**Që atë natë s'keni pasur asnjë lloj kontakti me Agronin?**

Jo, jo. Nuk kemi pasur asnjë lloj kontakti dhe nuk dimë asgjë.

**Përse mendoni se ka ndodhur kjo ngjarje?**

Nuk e kam asnjë ide se përse ka ndodhur dhe se çfarë ka ndodhur. Bashkëshorti im nuk kishte asnjë lloj problemi me askënd, as ndonjë shqetësim nuk më ka shfaqur kohët e fundit ndaj për ne është e paimagjinueshme se si kanë kaluar 6 ditë dhe s'kemi asnjë lloj informacioni apo kontakti.

Keni shkuar në polici dhe çfarë ju kanë thënë deri tani?

Po kam shkuar në polici dhe kam treguar këtë që po ju them edhe juve. Deri më tani policia nuk na ka dhënë asnjë informacion se çfarë ka ndodhur apo se ku ndodhet Agroni. Ne po përjetojmë një tmerr, sepse u bënë 6 ditë dhe s'dimë asgjë.

**Me çfarë merrej Agroni në jetën e përditshme?**

Si çdo njeri tjetër punon me servisin e motorëve që kemi te shtëpia. Normalisht edhe këtu ka rënë puna si çdo kund tjetër.

**Cili është apeli juaj për shtetin, por edhe për këdo që mund të ketë dijeni?**

Unë i bëj një apel të fortë qeverisë, kryeministrit, ministrit të Brendshëm, të drejtësisë dhe çdo strukture tjetër shtetërore që të bëjnë të mundur gjetjen e Agronit. Të paktën të dimë se çfarë ka ndodhur dhe se ku është Agroni. Sido që të jetë duam ta dimë. I bëj apel çdokujt që ka një informacion që të na tregojë. Shteti duhet që ta gjejë Agronin dhe të na thotë se çfarë ka ndodhur. Për ne është e pakuptueshme e gjitha kjo histori dhe po jetojmë ditë të vështira. Shpresoj që sa më shpejt të mësohet e vërteta dhe Agroni të kthehet në shtëpi.

### Me 31 gusht para Apelit, ish-kreu i ARRSH, Dashamir Xhika

# Abuzimet me rrugën "Tiranë-Elbasan", lihet në burg ish-drejtori, Albens Alite



Gjykata e Apelit për Krime të Rënda vendosi të mbajë sërish në qelitë e paraburgimit, ish-drejtorin e menaxhimit të projektit të rrugës Tiranë-Elbasan, Albens Alite, i dyshuar për korrupsion. Alite akuzohet për abuzime me tenderët gjatë ndërtimit të segmentit rrugor "Tiranë-Elbasan", dosje në të cilën po hetohen edhe ish-drejtuesi i ARRSH-së, Dashamir Xhika dhe ish-zyrtari, Aksel Qurduka. Ai kërkoi lirimin nga burgu me argumentin se ka përfunduar afati 6 mujor i paraburgimit dhe se mbahet padrejtësisht në izolim, për sa kohë që prokuroria nuk ka veprime të tjera hetimore për të kryer. Por shkalla e dytë e gjyqësorit nuk e mori në konsideratë këtë kërkesë të ish-zyrtarit të lartë. Po ashtu Apeli nuk doli me një vendim as për kërkesën e dytë të Alens Alites, i cili kërkonte shfuqizimin e vendimit të prokurorisë, për zgjatjen e afateve të hetimit edhe për tre muaj të tjera. Trupa gjykuese e pa të nevojshme të administronte dosjen hetimore e më pas të vendoste nëse pretendimet e Alites ishin ose jo të drejta. Ndërkohë, me 31 gusht përpara trupës gjykuese në Apelin e Krimeve të Rënda pritet të dalë Dashamir Xhika, ish-drejtor i autoritetit rrugor shqiptar, gjithashtu, i dyshuar për korrupsion me fondet e rrugës Tiranë-Elbasan. Ish-zyrtari i lartë prej disa javësh i ka lënë qelitë e paraburgimit dhe me vendimin të Gjykatës për Krime të Rënda, ndodhet nën masën e arrestit në shtëpi. Prokuroria e ankimoi vendimin e shkallës së parë dhe këmbëngul për rikthimin në burg të Dashamir Xhikës.

**AKUZA**

Albens Alite akuzohet për abuzime me tenderët gjatë ndërtimit të segmentit rrugor "Tiranë-Elbasan", dosje në të cilën po hetohen edhe ish-drejtuesi i ARRSH-së, Dashamir Xhika dhe ish-zyrtari, Aksel Qurduka. Ai kërkoi lirimin nga burgu me argumentin se ka përfunduar afati 6 mujor i paraburgimit dhe se mbahet padrejtësisht në izolim.

### I mbijetuari Martin Dogani: Ishte me shpejtësi rreth 130 km në orë

# Aksidentoi për vdekje dy kushërinjtë në Fier, gjykata lë në burg 24-vjeçarin

## *I heshtur në kafazin e hekurt, Amarildo Çalamani shfaq pendesë*

Ina Allkanjari

**FIER**

I heshtur dhe kokulur ka qëndruar përpara trupës gjykuese ditën e djeshme 24-vjeçari Amarildo Çalamani, shkaktari i aksidentit tragjik në fshatin Arapaj të Roskovecit, ku humbën jetën dy kushërinj. Ai ka mbërritur në gjykatë i prangosur dhe në sallën e gjyqit është shfaqur i tronditur dhe i penduar për ngjarjen. Gjatë seancës i riu e mbante kokën ulur dhe dorën mbi ballë për të treguar pendesë. Ndërkohë nuk ka pranuar të flasë përpara trupit gjykues teksa pyetej për ngjarjen e rëndë. Nga ana tjetër avokati i 24-vjeçarit tha se klienti i tij ndodhet në gjendje të ngarkuar psikologjike. Në përfundim të seancës gjyqësore të zhvilluara në gjykatën e Fierit, me kërkesë të prokurores Elida Hoxha, gjyqtarja Arta Duka vendosi masën e sigurisë "arrest me




Amarildo Çalamani

burg" për Çalamanin. Kujtojmë se 24-vjeçari është autor i aksidentit në Arapaj ku mbetën të vdekur dy kushërinjtë Amarildo dhe Festim Dogani dhe i plagosur Martin Dogani. Kushërinjtë po qëndronin në një trotuar të fshatit kur u goditën nga mjeti që drejtonte Çalamani. Mësohet se gjatë përplasjes makina lëvizte me shpejtësi rreth 130 km në orë në zonën e banuar. Fillimisht i riu u largua nga vendi i ngjarjes, por u arrestua disa minuta më vonë dhe u shoqërua në rajonin e policisë së Fierit. Çalamani është ndëshkuar shumë herë për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, por kjo e fundit iu mori jetën 2 të rinjve.

**NGJARJA**

Një aksident i rëndë i mori jetën dy kushërinjve Dogani mbrëmjen e së dielës në fshatin Arapaj të Roskovecit, ndërsa mbeti i plagosur një i tretë. Viktimat janë Amarildo Dogani 29 vjeç dhe Festim Dogani 21 vjeç, kushërinj me njëri-tjetrin. Ndërsa i plagosur ka mbetur Martin Dogani 22 vjeç, i cili ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën. Ata ishin duke ecur në anë të rrugës kur janë përplasur nga një makinë tip "Volkswagen" e drejtuar nga Amarildo Çalamani. Dyshohet se drejtuesi i mjetit që ka përplasur tre personat ka qenë me shpejtësi dhe ka përfunduar në kanal. Ai është larguar pas aksidentit, por është arrestuar pak minuta më vonë nga policia. Ndërkohë në këtë aks rrugor mungon ndriçimi dhe sinjalistika e duhur. "Në datën 26.08.2018, në orën 20:40, në urgjencën e Spitalit Fier janë sjellë në gjendje të rëndë shëndetësore e më pas kanë ndërruar jetë shtetasit A.D, 29 vjeç dhe F.D, 21 vjeç, të dy banues në fshatin Arapaj, Roskovec. Nga të dhënat paraprake, të dy shtetasit janë aksidentuar në fshatin Arapaj, nga një mjet që drejtohej nga shtetasi Amarildo Çalamani banues në fshatin Arapaj. Shërbimet e policisë bën të mundur kapjen e tij dhe e shoqëruan në Komisariatin e Policisë Fier për të kryer veprime të mëtejshme dhe zbardhjen e plotë të ngjarjes. Dy viktimat kanë qenë këmbësorë ndërsa mjeti ka dalë nga rruga dhe ka rënë në kanal", thuhet në njoftimin e policisë. Pa aksidentit të rëndë i tronditur nga përplasja dhe fundit fatal që patën dy çunat e xhajës së Martin Doganit, i riu tregoi se si rrodhi ngjarja. "Ne ishim 3 çuna xhaxhallarësh, rreth gjysmë metra nga trotuari jo në asfalt. Kishim pirë kafe dhe dolëm jashtë dhe po rrinim. Në muhabet e sipër dëgjojmë një zhurmë frenimi të madhe. Mua më kapi cepi i makinës dhe më përplasi në mur. Më pas unë ngela pa ndjenja. Dy çunat e xhaxhallarëve i përplasi për matanë. Ai ishte me shpejtësi, besoj me 130km në orë. Ka bërë frenim dhe në atë moment nuk e ka mbledhur. Rruga ku ndodhi aksidenti ka qenë skëterrë, por faji është i personave që nuk janë në rregull, sepse duhet të ecin me avash dhe nuk duhet të ecin me shpejtësi. Nuk është faji i rrugës",-u shpreh Martin Dogani.

**SHKURT**



### Qëlloi me 4 plumba 30-vjeçarin në Tiranë, identifikohet autori

**TIRANË**- Policia e Tiranës ka zbardhur ngjarjen e ndodhur ditën e martë gjatë orëve të mëngjesit ku mbeti i plagosur me 4 plumba një 30-vjeçar. Uniformat blu bëjnë me dije se kanë identifikuar një 28-vjeçar me inicialet F.G si autor të ngjarjes dhe e kanë shpallur atë në kërkim. Ndërkohë në pranga ka rënë dhe personi, i cili mbeti i plagosur Andi Spahia, pasi akuzohet për trafikim droge. Kjo pasi gjatë kontrollit fizik të ushtruar këtij shtetasi iu gjetën dhe bllokuan në cilësinë e provës materiale disa doza me lëndë narkotike të dyshuar të llojit Heroinë.



### Komisioneri Publik ankimon vendimin për prokuroren Sevdari

Komisioneri Publik ka apeluar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të Antoneta Sevdarit, prokurore në Prokurorinë e Tiranës. Prokurorja Sevdari, kandidate për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, u konfirmua në detyrë nga KPK në 18 korrik 2018. Por në vlerësimin e Komisionerit, institucioni që përfaqëson interesat e publikut në procesin e vetingut, hetimi i KPK për Sevdarin nuk ka qenë i plotë. Për këtë shkak Komisioneri është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për të riparuar vendimin e dhënë nga KPK.

**Shitje me Ankand te dyte nga Studio Permbarimore L.D.C**

"Truall + ndertese", me nr pasurie 31/12, ZK 3428, vol 5, fq 3 me siperfaqe totale trualli 1.837 m2 dhe siperfaqe ndertese 260.6 m2 me adrese fshati Shtoj i Ri, Shkoder. Regjistruar ne Z.V.R.P.P Shkoder ne emer te Zako Spaso Ajkoviq . Çmimi fillestar per shitje eshte 15.680.000 Leke.
Data e shpalljes **26.07.2018**
Data e zhvillimit **30.08.2018 deri ne oren 16.00**
Ankandi zhvillohet ne ambjentet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

Pasuria nr. 3/438+2-53, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 36, FAQE 37, SIPËRFAQE 103 M2, ZONA KADASTRALE 8380, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ALBAN QEMAL BALA.
**ÇMIMI 8.700.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 24.09.2018**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FAQE 179, SIPËRFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PËLLUMB META DHE ZNJ. RITA META
**ÇMIMI 4.118.696 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 13.09.2018**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

SPECIALE
DËNIMI I KADRI HAZBIUT



Ekskluzive / Raporti sekret i anëtarit të Byrosë Politike, lidhur me aktivin e Pogradecit për "Tablonë Sinoptike" të Enverit për Mehmetin

# Koleka: "Ja 21 pyetjet që më bënë në Pogradec për Mehmetin e Kadriun"

## *Raporti sekret: "Një nënë me shumë fëmijë qau në aktiv kur mësoi se Mehmeti do vriste Enverin"*

Ng Dashnor Kaloçi

Vetëm pak javë pas ngjarjes së 18 dhjetorit të largët vitit 1981, kur kryeministri Mehmet Shehu u gjet i vdekur në dhomën e tij të gjumit nga plumb-a pistolete në rrethana tepër misterioze për të cilat dhe sot pas 37 vjetësh vazhdohet të diskutohet ende, me porosi të Komitetit Qendror të PPSH-së, në të gjitha organizatat bazë të Partisë, në mbarë vendin, u mbajtën dhe u zhvilluan mbledhje të shumta, ku diskutohej; "nën frymën e fjalës së shokut Enver Hoxha, për armikun Mehmet Shehu", të cilat do t'i shërbenin më pas Enverit për të shkruar "Tablonë Sinoptike për poliagjentin Mehmet Shehu"?! Në të gjitha këto mbledhje, veç të tjerash, ashtu siç bëhet e ditur edhe nga një mori dokumentesh me siglën "Tepër sekret", që gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit, Arkivin e Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes, pjesëmarrës e diskutantë të shumtë që kanë marrë fjalën aty, kanë hedhur lloj-lloj akuzash, me të vërteta dhe të pavërteta, denoncime, spiunime, shpifje, trillime, thashetheme, intriga, sajesa e gjithfarë u kanë ardhur për shtat, të gjitha këto në drejtim dhe kundër ish-kryeministrit të vdekur, Mehmet Shehu, familjes së tij dhe atyre që u konsideruan bashkëpunëtorë të tyre, duke përmendur me dhjetëra emra, ushtarakë, funksionarë të lartë, etj. etj. Po kështu, këto mbledhje u intensifikuan së tepërmi, sidomos pas tetorit të vitit 1982, kur u arrestua dhe ministri i Mbrojtjes Kadri Hazbiu, (i cili për gati tri dekada me radhë kishte mbajtur postin delikat të ministrit të Brendshëm), ku dhe ndaj tij, u përsërit e njëjta tablo, si me ish-kryeministrin Mehmet Shehu. Dhe pas zhvillimit të këtyre mbledhjeve, komitetet e partisë të rretheve përkatëse, kanë hartuar një sërë raportesh me përmbledhje nga "problemet më kryesore", të cilat më pas ia kanë dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së. Për të gjitha këto mbledhje, gazeta "Panorama" disponon një numër të madh dokumentesh të nxjerra nga një dosje voluminoze me siglën "Tepër sekret", ku ish-anëtarë të Byrosë Politike, sekretarë të Komitetit Qendror të asaj kohe, si Spiro Koleka, Enver Halili, Vangjel Çerrava etj., etj., informojnë Komitetin Qendror për mbledhjet ku kanë marrë pjesë, duke dhënë me detaje dhe hollësira gjithçka është thënë dhe diskutuar aty. Po kështu përveç këtyre raporteve, në dosjen në fjalë, gjenden edhe një sërë raportesh të hartuara nga funksionarë të rangjeve më të ulta që nga Komiteti Qendror e më poshtë, apo dhe raporte kolegjiale të Degëve të Punëve të Brendshme në rrethe, shtabeve, komandave dhe komiteteve të partisë së Korpusve ushtarake, që ishin edhe njësitë më të mëdha që kishte Ushtria shqiptare asokohe. Nga kjo dosje voluminoze që "Gazeta Shqiptare" e disponon të plotë, në numrin e sotëm fillimisht po publikojmë raport-informacionin e ish-anëtarit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH-së, Spiro Koleka, dërguar Komitetit Qendror, lidhur me aktivin e partisë të rrethit të Pogradecit, ku ai ka marrë pjesë si i deleguar, më 25 shtator të vitit 1982. Për të vazhduar në numrat në vijim, (në tre shkrime radhazi) me raport-informacionin "Tepër sekret" të sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të Korçës, Enver Halili, dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së (personalisht Enver Hoxhës) lidhur me punën dhe veprimtarinë e Sigurimit të Shtetit në rrethin e Korçës si dhe "implikimin" e Mehmet Shehut, Kadri Hazbiut, Feçorr Shehut etj, me punonjës të Sigurimit dhe persona të tjerë në atë rreth dhe më gjerë.


Spiro Koleka


Mehmet Shehu takohet nga Byroja

PARTIA E PUNES SHQIPERISE Tepër Sekret
KOMITETI I PARTISE RRETHIT Ekz. Nr. 1
Nr. 675
Pogradec, më 28.9.1982

Lënda: Informacion "Mbi punimin e vendimit të Pleniumit të KQ të PPSH"

**KOMITETIT QENDROR TE PPSH SHQIPERISE**
GRUPIT TE INSTRUKTOREVE
TIRANE

Më datën 25 shtator 1982 sipas orientimeve të Komitetit Qendror të PPSh-së, u mbajt aktivi i partisë së rrethit, ku u punua vendimi i Pleniumit të 4-të të KQ të Partisë dhe fjala e shokut Enver "Tabllo Sinoptike për veprimtarinë agjenturore të armikut Mehmet Shehu".

Aktivi i Partisë në rreth u solidarizua plotësisht me materialet e këtij Pleniumi dhe me indinjatë dhe urrejtje të thellë dënoi veprimtarinë agjenturore e komplotiste të armikut Mehmet Shehu dhe bashkëpunëtorëve të tij.

Nga aktivi i komunistëve u miratua një rezolutë drejtuar Komitetit Qëndror të PPSH-së ku shprehet dashuria e pakufishme për partinë tonë tonë sokoleshë dhe udhëheqësin tonë të dashur shokun Enver Hoxha, i cili me guxim dhe zgjuarsi zbuloi dhe dënoi veprimtarinë agjenturore të armikut Mehmet Shehu e bandës së tij kriminale.

Më 26 dhe 27 shtator 1982, në të gjitha organizatat bazë të partisë të rrethit u punuan materialet e Pleniumit të 4-të të KQ të Partisë ku asistuan të deleguar të Komitetit të Partisë të rrethit. Nga organizatat-bazë të partisë janë dërguar për Komitetin Qëndror të Partisë, e Komitetin e Partisë të rrethit 41 letra e rezoluta.

Në të gjithë organizatat-bazë të Partisë, komunistët u solidarizuan unanimisht me vendimin e Komitetin Qendror të Partisë dhe fjalimin e shokut Enver në këtë Plenium. Kudo u tregua dashuria e zjarrtë për Partinë, Komitetin e saj Qëndror me shokun Enver Hoxha në krye, besimi i patundur tek udhëheqja e ndritur e partisë në rrugën e lavdishme të socializmit.

"Jam shumë e lumtur – tha ndërmjet të tjerave një komuniste – që jam anëtare e PPSH-së dhe ushtare e shokut Enver. Mbasi dëgjova fjalimin u mbusha me gëzim dhe krenari që kemi një Parti e udhëheqës si shoku Enver, i cili gjithmonë me vigjëlencë revolucionare e drejtësi të patundur ndaj Marksizëm-Leninizmit ecën në rrugën e ndritur të socializmit". Një komunist tjetër shprehet: "Ne këmi



Byroja Politike



PARTIA E PUNES E SHQIPERISE
KOMITETI PARTISE RRETHIT
Nr. 675

K.Q.P.P.SH. Nr. ...
Sekret

Ekz.Nr. 1
Pogradec, me 28 ...

Lenda: Informacion "Mbi punimin e vendimit te Plenumit te ...

KOMITETIT QENDROR TE PP SHQIPERISE
GRUPIT TE INSTRUKTOREVE
TIRANE

Me daten 25 shtator 1982 sipas orientimeve te KQ te ... u mblodh aktivi i Partise se rrethit, ku u punua vendimi i Plen... 4-t të KQ te Partise dhe fjala e shokut Enver "Tablo sinopti... veprimtarine agjenturore te armikut Mehmet Shehu".

Aktivi i Partise ne rreth u solidarizua plotesisht me ... let e ketij Plenumi dhe me indinjate e urrejtje te thelle d... tarine agjenturore e komplotiste të armikut Mehmet Shehu dhe ... punetoreve te tij.

Nga aktivi i komunisteve u miratua nje resolute drej... të PPSH ku shprehet dashuria e pakufishme per Partinë tonë ... dhe udheheqesin tone të madh, marksist-leninistin e shquar ... Enver Hoxha, i cili me guxim e zgjuaresi zbuloi e denoi vepr... agjenturore te armikut Mehmet Shehu e bandes se tij kriminal...

Më 26 dhe 27 shtator 1982 ne te gjitha organizatat-b... Partise te rrethit u punuan materialet e Plenumit të 4-t të ... Partise ku asistuan te deleguar te Komitetit të Partise te ... Nga organizatat-baze te Partise jane derguar per KQ te Parti... Komitetin e Partise te rrethit 41 letra e rezoluta.

Në të gjitha organizatat-baze te Partise komunistet ... rizuan unanimisht me vendimin e KQ te Partise dhe fjalimin ... Enver ne këtë Plenum. Kudo u tregua dashuria e zjarrte p... Komitetin e saj Qendror me shokun Enver Hoxha ne krye, ... tundur tek udheheqja e ndritur e Partise ne rrugen e lavdi...

./.

2

socializmit. "Jam shumë e lumtur - tha ndermjet te ... niste - që jam antare e PPSH dhe ushtare e shokut E... fjalimin u mbusha me gezim e krenari qe kemi nje Pa... tillë si shoku Enver, i cili gjithmone me vigjilence... drejtesi te patundur ndaj ML econ ne rrugen e ndritu... Nje komunist tjeter shprehet "Ne kemi fatin e madh q... shokun Enver Hoxha. Edhe femija i porsa lindur fytyr... grafia e shokut Enver. Për Partinë dhe shokun Enver ... asgje dhe do te jemi me ta sa te jetë jeta".

Nje komuniste, nënë me shumë fëmijë, kur dëg... banditi Mehmet Shehu kishte qëllim të asgjesonte shok... dit dhe filloi të qajë. Shprehje e qendrime të tilla ... shurinë e thellë për Partinë e shokun Enver ka patur ... stë.

Si nga aktivi i Partise në rreth, ashtu dhe nga organiza... bazë të Partisë i proposohet KQ të Partisë, që për merita të shqu... e revolucionar i madh, shokut Enver Hoxha t'i jepet edhe një herë ... tulli "Hero i Popullit" ose një titull tjetër më i lartë.

Aktivi dhe të gjithë komunistet e rrethit tone denuan ... veprimtarine agjenturore të armikut te përbindshem Mehmet Shehu dhe ... komplotisteve të urryer, bashkepunetore të tij. Një komunist i mo... duke folur me urrejtje per tradhtarin e kriminelin e pabesë Mehm... Shehu tha : "Haram i qoftë buka që ka ngrënë nga populli ky armik ... betuar i Partisë".

Nga organizatat-baze te Partise eshte propozuar qe mbi b... punetoret komplotiste te Mehmet Shehut e lakejtë e tij të godasë ... për shpata e drejtësisë sonë popullore duke u dhënë dënimet më të ... renda.

Kudo, komunistet u sotuan se do te studiojne e thellohen ... rreshtur ne dokumentet e Partise dhe veprat e shokut Enver, do t... zhvillojnë drejt luftën e klasave dhe duke vleresuar me seriozite...

./.

fatin e madh që në krye kemi shokun Enver Hoxha. Për Partinë dhe shokun Enver nuk do të kursejmë asgjë dhe do të jemi me të sa të jetë jeta".

| 24 | 181807300026 | 129657.73 |
| 25 | 181114200007 | 129603.83 |
| 26 | 180709500073 | 129600.57 |
| 27 | 182921800080 | 129495.33 |
| 28 | 181215000153 | 129406.43 |
| 29 | 182922800002 | 129390.80 |
| 30 | 181807300116 | 129320.57 |
| 31 | 181705900223 | 129092.83 |
| 32 | 183440800019 | 128435.07 |
| 33 | 181807200298 | 128374.40 |
| 34 | 181939400078 | 128325.87 |
| 35 | 181114100001 | 127892.10 |
| 36 | 181113000010 | 127601.83 |
| 37 | 180101400018 | 127355.67 |
| 38 | 181112600068 | 127032.97 |
| 39 | 182526300177 | 126234.03 |
| 40 | 181112700002 | 125899.67 |
| 41 | 180710000005 | 125879.60 |
| 42 | 183123700012 | 125841.10 |
| 43 | 181317300029 | 125741.23 |
| 44 | 182526300221 | 125511.87 |
| 45 | 183123700028 | 125452.83 |
| 46 | 181705900051 | 125114.03 |
| 47 | 180709500027 | 124943.70 |
| 48 | 182829500037 | 124505.27 |
| 49 | 180709500048 | 124462.57 |
| 50 | 181936300105 | 124447.17 |
| 51 | 181939400114 | 124047.00 |
| 52 | 181937900337 | 123965.80 |
| 53 | 182232800055 | 123942.93 |
| 54 | 183724400004 | 123628.87 |
| 55 | 180504900001 | 123593.40 |
| 56 | 181215000142 | 123412.10 |
| 57 | 181939700042 | 123214.70 |
| 58 | 181706500030 | 122964.10 |
| 59 | 180708700003 | 122714.43 |
| 60 | 180504000003 | 122514.93 |

**PROGRAMI I STUDIMIT LOGOPEDI: 2018-2019 RAUNDI I**

| Nr | ID MATURANTI | PIKET |
|---|---|---|
| 1 | 181706400025 | 142849.84 |
| 2 | 181705200204 | 142209.90 |
| 3 | 182629900008 | 142022.07 |
| 4 | 181939400176 | 141900.97 |
| 5 | 180810700010 | 141900.03 |
| 6 | 181938700021 | 141764.00 |
| 7 | 182326900332 | 141560.07 |
| 8 | 182629900009 | 141113.47 |
| 9 | 181706100011 | 140786.80 |
| 10 | 182232600052 | 140739.20 |
| 11 | 181706500008 | 140710.73 |
| 12 | 182327800069 | 140654.03 |
| 13 | 181705200137 | 140559.30 |
| 14 | 182232600095 | 140544.13 |
| 15 | 181706400077 | 140219.94 |
| 16 | 182232600096 | 140189.00 |
| 17 | 181939100032 | 139989.97 |
| 18 | 181937900048 | 139915.77 |
| 19 | 182922400182 | 139866.30 |
| 20 | 181114200103 | 139751.03 |

**PROGRAMI I STUDIMIT MAMI: 2018-2019 RAUNDI I**

| Nr | ID MATURANTI | PIKET |
|---|---|---|
| 1 | 181114000015 | 142611.00 |
| 2 | 181705200001 | 142425.50 |
| 3 | 181939300098 | 141068.20 |
| 4 | 182232600052 | 140739.20 |
| 5 | 181705200137 | 140559.30 |
| 6 | 181746600038 | 139841.33 |
| 7 | 183145200026 | 139748.47 |
| 8 | 181114200074 | 138868.33 |
| 9 | 181939700165 | 138429.67 |
| 10 | 181114200013 | 138413.10 |
| 11 | 183145200010 | 138112.33 |
| 12 | 181939700238 | 138032.53 |
| 13 | 183123700020 | 137234.53 |
| 14 | 181956400006 | 137226.60 |
| 15 | 181939400008 | 137061.40 |
| 16 | 180100200085 | 136809.05 |
| 17 | 181939700387 | 136683.17 |
| 18 | 180100200236 | 136496.15 |
| 19 | 183123700006 | 136293.50 |
| 20 | 181215000190 | 136239.60 |
| 21 | 181317300021 | 136197.60 |
| 22 | 181706600034 | 136196.90 |
| 23 | 183123300013 | 135289.93 |
| 24 | 183625000165 | 135206.87 |
| 25 | 181939300125 | 135200.57 |
| 26 | 181146900012 | 135075.97 |
| 27 | 181936400030 | 134722.00 |
| 28 | 183123300020 | 134539.30 |
| 29 | 181011200005 | 134526.70 |
| 30 | 181706600084 | 134416.80 |
| 31 | 182526400046 | 134140.53 |
| 32 | 180101200125 | 134014.53 |

**PROGRAMI I STUDIMIT TEKNIKE IMAZHERIE: 2018-2019 RAUNDI I**

| Nr | ID MATURANTI | PIKET |
|---|---|---|
| 1 | 181114000003 | 143434.20 |
| 2 | 182629600025 | 142937.90 |
| 3 | 181938800058 | 142759.63 |
| 4 | 181114000015 | 142611.00 |
| 5 | 183359300012 | 142492.00 |
| 6 | 181705200001 | 142425.50 |
| 7 | 181705200204 | 142209.90 |
| 8 | 181706600039 | 142164.40 |
| 9 | 182134200027 | 142025.33 |
| 10 | 181114700008 | 141582.70 |
| 11 | 180403700182 | 141540.00 |
| 12 | 181706400144 | 141412.60 |
| 13 | 182629900009 | 141113.47 |
| 14 | 182232600156 | 141075.20 |
| 15 | 181114000086 | 140960.40 |
| 16 | 182232600113 | 140808.50 |
| 17 | 181706100011 | 140786.80 |
| 18 | 181706500008 | 140710.73 |
| 19 | 181936100049 | 140694.40 |
| 20 | 181935700022 | 140686.93 |
| 21 | 182327800069 | 140654.03 |
| 22 | 181705200137 | 140559.30 |
| 23 | 181807200195 | 140416.50 |
| 24 | 181936300076 | 140354.20 |
| 25 | 182526300162 | 140282.80 |
| 26 | 181948200016 | 140281.87 |
| 27 | 181705000024 | 140261.33 |
| 28 | 181706400077 | 140219.94 |
| 29 | 181938800044 | 140193.20 |
| 30 | 181216800011 | 140024.50 |
| 31 | 181936100034 | 139948.90 |
| 32 | 183825800028 | 139872.60 |
| 33 | 181937900276 | 139868.63 |
| 34 | 181746600038 | 139841.33 |
| 35 | 181114200103 | 139751.03 |
| 36 | 182232600068 | 139720.70 |
| 37 | 181939700323 | 139589.57 |
| 38 | 182526300211 | 139583.50 |
| 39 | 182232600034 | 139559.00 |
| 40 | 181113300033 | 139554.10 |
| 41 | 183220300038 | 139503.00 |
| 42 | 181706400006 | 139494.74 |
| 43 | 181946000030 | 139487.60 |
| 44 | 181113500184 | 139463.57 |
| 45 | 181807300008 | 139442.10 |
| 46 | 182232600012 | 139426.00 |
| 47 | 181705200218 | 139371.82 |
| 48 | 181939700117 | 139327.77 |
| 49 | 183220300007 | 139291.60 |
| 50 | 182630500003 | 139291.60 |

In Memoriam

# BISEDË E LIRË ME NJË SHOQE. BËJ Ç'TË DUKET MË E BUKUR…

Nga Atjon Zhiti

*(vijon nga faqja 1)*

… të ndryshme. Ishte dhe një veprimtar në Parlamenti Europian Rinor dhe ëndërrimtar i një Shqipërie më të bukur.

Kemi zgjedhur pjesë nga libri i tij "Për atë që dua(m)", përsiatje dhe ndjesi të një djaloshi, që të mrekullojnë me sinqeritetin dhe mençurinë rinore….



### KËRKIMI ËSHTË ZHVESHJE:

…Ne i futemi thellë të vërtetës. Sa thjeshtë e zhveshim atë. Preferojmë sinousitetin e elegancën ndaj mbulesës, por në fund del që lëkura lakuriq është më e komplikuar se mbulesa dhe fundi pastaj bëhet i thjeshtë… Por rruga është keq. Ka shumë gropa. Kërkimi është zhveshje.

Ti je bionde në shpirt… si feministe e flaktë që je, duhet të mbroje biondet dhe të flisje për barazinë e tyre gjinore… Mënyra më e mirë sot për të bërë *equality* është që lëvizjet feministe të mos ekzistojnë. Sa do të forta ose jo, nqs një organizatë e tillë e ekziston, detyrimisht kuptohet që femra në përgjithësi ndihet e subordinuar.

…ndjej një antipati për shkollën. Më duken orë të humbura. Mos ma përmend fjalën shkollë. E urrej shkollën dhe librat që na jep për të lexuar... Shkolla ime nuk më stimulon, nuk më mëson gjë të re, nuk mendon në nivelin tim, më fal për modestinë…

### PËR OPINIONIN, SPEKTAKLI SI REALITET:

Duhet kuptuar shoqëria për të folur për një fenomen shoqëror, të paktën sado pak. Sot në shoqërinë tonë, tërë jeta e shoqërive, ku mbretërojnë kushtet moderne të prodhimit, prezantohet si një akumulim i madh spektaklesh.

Spektakli, në këtë rast programi juaj, për shembull, nuk është më një bashkësi imazhesh, por një raport social që ka imazhin si medium. Realiteti kështu lindte spektaklin dhe spektakli bëhet real.

Imazhi është mall dhe malli kështu ngarkohet me imazhe, imazhe spektakolare, të cilat e mbushin mallin plot jetë dhe çojnë konsumatorin e pamundur për shumë në iluzion.

Ky mall i kthyer kështu nuk e ka çliruar njeriun nga nevoja, por i ka ushtruar një presion të ri, një kusht të ri, konsumizmin. Në saje të kthimit në mallit në parësi, malli ngarkohet me alegori e kuptim simbolik. Malli konsumohet me dukjen, nuk duhet më për mbijetesën dhe kështu pra kemi një mbijetesë të mbingarkuar. Akoma më e shterpët se nevoja e mbijetesës. Në shoqërinë tonë është dramatike se si të qenit zëvendësohet nga dukja.

### PATRIOTIZMI I ARENËS MODERNE:

Nuk e gëlltis dot shumë patriotizmin e lindur befas nga një *ndeshje*, ka një të qenë të zbehtë, të shtirur e të pavlerë.

Atdhetarizmi i vërtetë, kur ndihet, arrihet të shprehet në të gjitha mënyrat e manifestimit që ka, qoftë të heshtura dhe të padukshme. Nëpër mend më kalon kënaqësia e krenaria për progreset e arritura, për kulturën që ekziston në dheun, ku kjo ndjenjë të përket, për dëshirën për të ruajtur karakteristikat, trashëgiminë e pse jo dhe traditat…

Patriotizmi ama nuk është vetëm kaq, patriotizmi ka dhe një fizionomi etike, sepse bashkë me atdheun dhe tek atdheu shihet një standard, një vlerë morale më vete që duhet forcuar vazhdimisht, duhet përkryer e rrezatuar në çdo akt tonin. Ndërkaq një individ i tillë, që në të vërtetë ndihet i përfshirë në këtë "rrymë", vendos interesat e kombit përpara atyre personale, diçka e tillë "leverdis" shumë e më shumë, se sa të varfrat nevoja vetjake.

Për mendimin tim ajo ndeshja e asisojshme e paradokohshme vetëm ndeshje nuk qe, por jam tejet i lumtur që çunat mbrojtën simbolet tona, eventi ama ishte një gati-shfryrje politike e vendeve, të cilat plot me probleme nuk arrijnë të shprehen e të mbërrijnë rezultate në arenën politike… Ne aritëm të tregojmë diçka, por ama betejën e radhës përsëri se si bën dhe e fiton kundërshtari.

Ata vazhdimisht vazhdojnë të hedhin baltë, pa ia treguar kush dhëmbët e të vërtetës siç duhet. Ne, si gjindje, nuk kemi një ndjenjë kush e di sa të fortë atdhetare, si një zeje të brendshme do të thosha, jo si shpërthime.

Ajo çka fatkeqësisht dimë të bëjmë më mirë, është të tejçojmë vuajtjet e të parëve tanë brez mbas brezi, të flasim me mllef (me të drejtë në shumë raste, po jo e drejtë gjithashtu, sepse politika nuk përbën një popull të tërë, edhe vetë nuk besohem të jam ndjerë i përfaqësuar nga politikat e vendit tim.)

…ndjenja e dashurisë kundrejt vendit rritet ende më shumë bashkë me njohjen, qoftë dhe duke parë më shumë e më shpesh trojet…

### Livias ca fjalë për Filozofinë:

Shumë herë kemi thënë të filozofojmë, por asnjëherë nuk e kemi bërë tamam. Direkt ndjej atë frymën, atë entuziazmin dhe atë dëshirën e të bërit atë çka do e më pëlqen.

Po lexoja një libër dhe nënkuptonte se jeta nuk duhet mbivlerësuar duke menduar se është e gjatë dhe e përjetshme, nuk kemi kohë për gjithçka, por njëkohësisht nuk duhet nënvlerësuar duke thënë se është e kotë, e shkurtër dhe e pavlefshme, jeta është një hua dhe ne duhet ta lajmë atë duke bërë mirë. Të bësh mirë ti e di ça dmth, nuk flitet vetëm për nota e sjellje. Flitet për pasion, dëshirë, këmbëngulje, sakrifica ndoshta dhe vuajtje, por pasioni është kryesori.

Nqs ti vërtet ndjen dhe ke dëshirë të bësh filozofi, jo vetëm si degë, ti duhet patjetër ta bësh atë.

Dashuria për dije është e pakohë dhe e tillë do të jetë.

Do doja të zgjatesha më shumë me "filozofinë", por s'di a duhet. Shkurt nqs do ta bësh, bëje atë, por më mirë do ishte, mendoj, mos ta ndaje, filozofia është gjithçka, por jo gjithçka është filozofi.

Dostojevskij thoshte se bukuria do të shpëtojë botën, nuk flitet vetëm për atë fizike dhe shpirtërore. Bëj çka të duket më e bukur!

Opinioni i Ditës

# Misioni i "dhëndrit" shqiptar

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)



... aluduar për origjinën shqiptare të tij, edhe pse ende nuk ka prova. Berati, dhëndri 40-vjeçar i Presidentit turk Erdogan ka përpara vetes dhe vendit të tij një detyrë të vështirë. Të qetësojë tregjet e kapitalit dhe investuesit turq dhe të huaj, të frikësuar nga rënia kokëposhtë e vlerës së lirës turke në tetë muajt e parë të këtij viti. Ndryshe nga i vjehrri që është mjeshtër i retorikës së ashpër politike, Albayrak u përpoq që në ditët e para të detyrës së re, që të dialogojë dhe të sigurojë investuesit vendas dhe të huaj. U premtoi disiplinë fiskale, masa kundër inflacionit, një bankë qendrore të pavarur dhe reforma strukturore. Më 20 korrik u tha gazetarëve turq që udhëtonin me të, pas një takimi të ministrave të financave të G-20 (Grupit të 20 vendeve më të mëdha të botës), se ai "nuk do të luftojë tregjet". Më 23 korrik 2018, ministri i ri turk i Financave ftoi 15 ekonomistë dhe figura të shquara nga industria e financave të Turqisë, në një takim në Stamboll. Sipas gazetës së mirënjohur "Financial Times", z. Albayrak tregoi një kuptim të qartë të sfidave makroekonomike me të cilat ballafaqohet Turqia dhe theksoi se "gjërat do të trajtohen në mënyrë të ndryshme nga më parë". Me këto premtime, pikërisht kur të gjithë prisnin që më 24 korrik 2018, në takimin e radhës së Komitetit drejtues të bankës qendrore turke, të ngriheshin normat e interesit, kjo bankë nuk i rriti ato. Në vend të vendimit shpëtimtar, bëri disa ndërhyrje, duke i thjeshtuar procedurat se si bankat tregtare merrnin hua prej saj. Ishte një gabim i madh dhe një mundësi e humbur nga banka qendrore për të konsoliduar kredibilitetin e vendosur me tri rritje të normës së interesit, deri në zgjedhjet e qershorit 2018 në Turqi. Me sa duket, Albayrak ia ka kërkuar rritjen e normës së interesit dhe Erdogan ka thënë "Jo!". Më 10 gusht 2018, Presidenti Amerikan Tramp deklaroi dyfishimin e tarifave të importit për çelikun dhe aluminin turk. Tarifat e rritura në vetvete kanë një impakt të vogël në ekonominë turke si të tërë, prej vetëm 1 miliardë dollarë(875 milionë euro) më shumë. Mirëpo kjo ishte pika që derdhi të gjithë kovën. Menjëherë lira turke humbi brenda 24 orëve 18 përqind të vlerës së saj. Punonjësve të bursës në Stamboll kjo nuk u kishte ndodhur asnjëherë në karrierën e tyre. Zhvlerësimi i monedhës vendase, në krahasim me 1 janarin 2018, arriti në 45 përqind. Inflacioni në Turqi u rrit në 15.4 përqind në korrik, norma më e lartë vjetore që nga viti 2004. Megjithatë, Albayrak nuk u dorëzua. Investuesve të huaj ju tha se Turqia do të dilte më e fortë nga kriza e monedhës, duke këmbëngulur se bankat turke janë të shëndetshme. Tre ditë më vonë, deklaroi një plan masash të bankës qendrore dhe të të gjithë qeverise turke, për të frenuar rënien e lirës. Me këtë rishikim dhe lehtësim të kostos së mbajtjes së rezervave në monedhën vendase, banka qendrore turke po provon t'i sigurojë sistemit financiar afërsisht 10 miliardë lira turke, 6 miliardë dollarë amerikanë dhe 3 miliardë dollarë amerikanë të barabartë me likuiditet ari(të vlerësuar në ar). Alkbayrak bëri dhe një lëvizje tjetër. E bindi bankën e frikësuar qendrore të vendit të tij të rriste, sikurse do ta quante gazeta 'Financial Times', "normat e interesit nga deriçka". Çfarë ndodhi? Këtë e shpjegon "Financial Times". Për dy ditë, pas njoftimit të planit me 13 gusht(14-15 gusht 2018), banka qendrore nuk rriti normën e saj të interesit, fiksimin e Erdogan, por ndërpreu, që nga 14 gushti 2018, dhënien e huave bankave të nivelit të dytë përmes ankandeve të zakonshme të parave( një javore me 17.75 për qind interes), duke i detyruar ato të marrin hua brenda 24 orëve (hua njëditore) me 19.25 për qind, duke e rritur praktikisht normën e interesit ose çmimin e financimit me 1.5 përqind! Një manovër e tillë nuk ka gjasa të prodhojë efektin e dëshiruar, sigurinë dhe garancinë për investuesit dhe tregjet. Por të paktën qetësoi disi këmbimin e lirës turke me dollarin. Lira ka rikuperuar pak nga humbjet e saj deri më 25 gusht 2018. Albayrak po provon një mision gati të pamundur. Urojmë të këtë sukses sadopak, në të mirë të ekonomisë së Turqisë, këtij vendi të madh dhe partnerit tonë të tretë në tregti, për nga importet që marrim nga Turqia.

Zhvlerësimi i monedhës vendase, në krahasim me 1 janarin 2018, arriti në 45 përqind. Inflacioni në Turqi u rrit në 15.4 përqind në korrik, norma më e lartë vjetore që nga viti 2004. Megjithatë, Albayrak nuk u dorëzua. Investuesve të huaj ju tha se Turqia do të dilte më e fortë nga kriza e monedhës, duke këmbëngulur se bankat turke janë të shëndetshme.

## HOROSKOPI

### DASHI

Natyra ju ka dhuruar besim në vetvete dhe inteligjencë, kështu që përdoreni atë, ashtu siç duhet. Vështirësitë financiare mund t'ju çojnë drejt kritikave dhe argumenteve. Përgatituni t'iu thoni jo personave që presin shumë prej jush.

### DEMI

Ka gjasa të përballeni me kritika për shkak të zakonit tuaj për të kritikuar shumë të tjerët. Sot do të keni dëshirë të udhëtoni dhe të shpenzoni para, por më pas do t'ju vijë keq nëse e bëni një gjë të tillë. Mund të keni një zënkë me partnerin/partneren tuaj për shkak të shpenzimeve.

### BINJAKET

Mos i humbisni energjitë duke i përdorur për gjëra të panevojshme, por përdoreni ato në drejtimin e duhur. Disa shpenzime të papritura do t'ju prishin ekuilibrin ekonomik. Sigurohuni që të mos bëni ndryshime në arredimin e shtëpisë pa marrë miratimin e të tjerëve.

### GAFORJA

Përpiquni ta shijoni jetën sa më shumë të jetë e mundur. Përpiquni të ruani qetësinë para se t'ju dalë situata nga kontrolli në shtëpi. Sa i përket anës romantike, do të jetë dita e duhur. Një projekt të cilin keni kohë që e prisni do të shtyhet ende.

### LUANI

Duhet të kujdeseni më shumë për trupin duke bërë ushtrime vazhdimisht. Mos harroni asnjëherë se një fizik i shëndetshëm sjell edhe një mendje të shëndetshme. Mos ndërmerrni vendime të nxituara, sidomos kur keni të bëni me marrëveshje të mëdha financiare.

### VIRGJERESHA

Sot nuk është një ndër ditët e tua me fat, kështu që bëni kujdes me fjalët që përdorni. Një nga të afërmit do të irritohet shumë nga veprimet tuaja të fundit. Komunikimi me partnerin/partneren do t'ju ndihmojë për t'i menduar gjërat më mirë.

### PESHORJA

Përpiquni të relaksoheni sa më shumë të jetë e mundur, mbi të gjitha pas pune. Të ardhurat financiare do të rriten në pjesën e dytë të ditës. Sot do të vendosni ekuilibrat në familjen tuaj.

### AKREPI

Është koha e duhur që personat, të cilët vuajnë nga zemra të heqin dorë nga kafeja, pasi konsumi i tepërt i saj mund t'ju rrisë tensionin. Sot do të përjetoni ulje ngritje në çift. Megjithatë është dita e artë për t'i dhuruar dashuri njëri-tjetrit.

### SHIGJETARI

Tensioni në punë do t'ju shkaktojë stres. Ka gjasa të pësoni humbje nëse investoni pa marrë këshillat e duhura. Do të keni nevojë për ndihmë nga të afërmit tuaj. Përpiquni të mendoni pozitivisht sa më shumë të jetë e mundur.

### BRICJAPI

Tregoni durim, pasi ky do të jetë çelësi i suksesit tuaj. Aktivitetet sociale në mbrëmje mund të kalojnë pritshmëritë tuaja. Mund të takoni dikë që do t'ju bëjë të përjetoni ekstazinë e dashurisë.

### UJORI

Do të jeni të pasiguritë rreth asaj çfarë dëshironi. Sot ka gjasa të humbisni dashurinë e vërtetë. Megjithatë mos u shqetësoni se gjithçka ndryshon me kohë. Përqendrohuni në punë dhe qëndroni larg konfrontimeve emocionale.

### PESHQIT

Mos e humbisni qetësinë për asnjë lloj arsye pasi do të shkaktojë probleme të përhershme në familjen tuaj. Sot nuk do të jeni shumë i duruar, por bëni kujdes me fjalët pasi mund të ofendoni njerëzit përreth jush.

Flasin pasagjerët: Qanim e bërtisnim, ishim në panik pasi pamë tymin

# Zjarr në anijen greke, shpëtojnë mbi 1000 pasagjerë mes tyre dhe shqiptarë

## *Pesë orë tmerri, odiseja e tragetit "Eleftherios Venizelos"*

Ka zgjatur pesë orë odiseja e ngjarjes së tmerrshme të ndodhur në tragetin "Eleftherios Venizelos", e cila mori flakë me mbi 10 mijë pasagjerë në bord. Saktësisht kanë qenë 875 pasagjerë dhe 141 pjesëtarë të ekuipazhit në bord që janë shpëtuar. Mediat greke shkruajnë se nga ora 12 e natës deri në 4:40 të mëngjesit ka zgjatur makthi i njerëzve në bordin e anijes që mori flakë. Raportohet se zjarri filloi në garazhin e anijes dhe u përhap në pjesën tjetër. Pasagjerët me maska u nxorën nga anët dhe jo në anën e pasme, siç ndodh zakonisht, por nga dalja e sigurisë. Në port i prisnin policia dhe zjarrfikësja. Ndërkaq një pasagjere e tragetit "Eleftherios Venizelos", e cila u përfshi nga flakët gjatë natës, ka rrëfyer për median greke "Protothema", momentet e panikut që përjetoi në ato çaste. "Kam qarë e bërtitur me atë që mësova se po na ndodhte. Ekuipazhi shpërndante ujë dhe xhaketa shpëtimi. Ne ishim në panik pasi pamë tymin, por bëmë durim, derisa arritën të dilnim të gjithë mirë. Ekuipazhi bëri gjithçka që mundi për të na ndihmuar,"- tha ajo. Ende mbetet mister shkaku i përfshirjes nga zjarri të tragetit që lundronte në Egje me 875 pasagjerë, por ndërkohë edhe kryebashkiaku grek i Platanias, i cili mësohet të ketë qenë në traget, tregoi për momentet e panikut të përjetuar: "Na dhanë jelekë shpëtimi. Rreth orës 12:00 kemi marrë një paralajmërim për të shkuar në diskotekë dhe dhomën e ndjenjës", tha Malandrakis për minutat e para pas zjarrit, ndërsa anija kishte ngadalësuar lëvizjen para se te ndalonte përfundimisht. "Na thanë se ka rënë zjarr në garazh", vazhdoi ai. "Në fillim, po ecnim shumë ngadalë, pastaj anija ndaloi,"- tha Ioannis Malandrakis. Ndërkaq anija greke "Eleftherios Venizelos" ishte nisur në mesnatë nga porti i Pireut me destinacion për në Xania. Zjarri nisi fillimisht në garazhin e automjeteve dhe të bagazheve, ku pati edhe disa shpërthime. Situata u mbajt nën kontroll nga brigada e zjarrit të anijes. Rreth orës 02:30 kur zjarri ishte nën kontroll, anija ndryshoi drejtim duke u kthyer sërish pas për në portin e Pireut. Gjatë gjithë udhëtimit, vatra e zjarrit mbahej nën monitorim. Anija "Eleftherios Venizelos" udhëtonte me shpejtësi 16 nyje dhe mbërriti në portin e Pireut rreth orës 04:00. Për shkak se zjarri nuk ishte fikur plotësisht, u vlerësua se pasagjerët nuk mund të zbrisnin nga seksioni i pasmë pasi përbënte rrezik. Në këtë mënyrë u gjet një zgjidhje tjetër. Udhëtarët dolën nga një seksion anësor i anijes me ndihmën e një shkalle të posaçme, duke zbritur në një anije tjetër. U deshën rreth 40 minuta që nga anija e përfshirë nga zjarri të dilnin të gjithë pasagjerët. Prioritet u është dhënë fëmijëve dhe të moshuarve. Pasi mbërriti në portin e Pireut, 875 pasagjerët pritën rreth 1 orë e gjysmë përpara se të zbrisnin. Atyre iu shpërndanë maska për t'u mbrojtur nga tymi. E gjithë situata ndërkohë monitorohej edhe nga ajri përmes helikopterit të ushtrisë. E gjithë kjo aventurë e keqe që rrezikonte të kthehej në tragjedi, fatmirësisht u mbyll pa pasoja dhe pa persona të lënduar, përveç dëmeve materiale. Shkaqet e ngjarjes janë të paqarta. Zjarri tani është fikur plotësisht dhe ka nisur një hetim për të zbuluar rrethanat.






**RRËFIMI I PASAGJERES:**
"Kam qarë e bërtitur me atë që mësova se po na ndodhte. Ekuipazhi shpërndante ujë dhe xhaketa shpëtimi. Ne ishim në panik pasi pamë tymin, por bëmë durim, derisa arritën të dilnim të gjithë mirë. Ekuipazhi bëri gjithçka që mundi për të na ndihmuar,"- tha ajo.

**PASAGJERI TJETËR, KRYEBASHKIAKU I PLATANIAS:**
"Na dhanë jelekë shpëtimi. Rreth orës 12:00 kemi marrë një paralajmërim për të shkuar në diskotekë dhe dhomën e ndenjës. Na thanë se ka rënë zjarr në garazh", vazhdoi ai. "Në fillim, po ecnim shumë ngadalë, pastaj anija ndaloi,"- tha Ioannis Malandrakis.

---

### Refugjatja i kujton 'Otranton': 81 vetë u mbytën atëherë

## Shqiptarja letër "thumbuese" Salvinit: S'e harrojmë shprehjen 'hidhini në det'!

Pas falënderimit zyrtar që bëri ministri i Brendshëm italian, Mateo Salvini ndaj Ditmir Bushatit për pranimin e 20 refugjatëve në anijen "Diccioti", një reagim ndaj tij është bërë ditën e djeshme nga një emigrante shqiptare. Sonila Alushi i ka drejtuar ministrit të Brendshëm italian Matteo Salvini një letër të hapur në lidhje me pranimin e 20 emigrantëve të anijes "Diccioti" nga qeveria italiane. Ajo jeton me familjen prej shumë vitesh në Bergamo, Itali. Alushi drejton fondacionin "Migra" dhe është aktiviste e mbrojtjes së të drejtave të emigrantëve. Aktivistja i është drejtuar atij me këto fjalë:

Shqipëria u tregua solidare me këtë vend, Zoti Ministër, jo me ju. Shqipëria është një popull emigrantësh, është një popull bujar dhe mikpritës edhe pse ende i varfër. Por mbi të gjitha Shqipëria nuk harron ndihmat e shumta nga fqinjët e vet italianë. Ashtu siç nuk harron deklaratat tuaja përbuzëse si kjo e fotografisë më poshtë marrë nga faqja juaj e 'Facebook'-ut. Apo frazat e dhunshme të shkruara jo shumë kohë më parë, nga mbështetësit tuaj, në muret e Lombardisë, si "Shqiptarët duhen varur"! Oh jo, ne nuk harrojmë deklaratën e turpshme të deputetes tuaj (atëherë quheshit Liga e Veriut), asokohe Kryetare e Parlamentit italian, Irene Pivetti, e cila pa minimumin e druajtjes dhe ndjenjës, tha që SHQIPTARËT DUHESHIN HEDHUR NË DET! Dhe të hedhur në det ne përfunduam vërtetë vetëm pak ditë më pas: e kish emrin Katër i Radës ajo anija e vogël që u fundos në Otranto. U mbytën 81 shqiptarë e midis tyre fëmijë, gra, burra e të moshuar. I vunë emrin "Gjëma e të Premtes së Shenjtë" asaj tragjedie në 28 Mars 1997. Vajtuam nga veriu në jug për ata të vdekur, një vend i tërë mbajti zi. Por, më pas, anijet dhe skafet vazhduan gjithsesi të lundrojnë drejt Italisë, sepse ishte çështje mbijetese dhe ju Ministër e dini mirë, edhe pse bëni sikur s'dini! Ju bëni sikur s'e kuptoni pse njerëzit braktisin shtëpitë e tyre, për të ardhur drejt Europës, duke rrezikuar jetën në det. Ju bëni gjoja, Ministër, bëni gjoja në lidhje me shumë gjëra. Edhe për faktin që, duke ju dëgjuar ju, problemet më të mëdha të këtij vendi duket sikur vijnë nga emigrantët dhe refugjatët. Nuk patëm kohën të na thahen lotët për viktimat e Xhenovas dhe Çivitës, se ja ku dolët ju me një vendim mizor (mbi anijen 'Diciotti', e cila u bllokua në brigjet italiane me në bord refugjatët nga Eritrea, të cilët po vuanin nga sëmundje të ndryshme në kushte higjienike të turpshme) për të na bërë të qajmë dhe turpërohemi për viktima të tjera; nuk arritëm të mbanim zi për ata të vdekur e të kuptonim diçka lidhur me rrëzimin e asaj ure, se ja ku na dolët ju me ankesat tuaja të zakonshme të cilat e drejtojnë gishtin vetëm nga emigrantët! Shqipëria, me këtë gjest, duke u pozicionuar qartë në krah me Italinë, u tregua mirënjohëse dhe bujare sepse ky vend e meriton dhe ky vend nuk përfaqësohet vetëm nga ju. Mos e përdorni këtë gjest në favorin tuaj personal, mos na trajtoni si budallenj. Faleminderit!"



---

SHKURT



### Australi, një sferë e ndritshme zbret nga qielli e trondit vendin

Një top i ndritshëm ka kaluar në qiellin e Australisë perëndimore, duke ngjallur shumë debate online. Qindra persona kanë konfirmuar që topi i madh ndriçues mund të ketë qenë një meteor. Observatori i qytetit Perth ka marrë shumë sinjalizime për këtë fenomen. Disa banorë kanë thënë, gjithashtu, se kanë dëgjuar një zhurmë të fuqishme dhe kanë ndjerë dritaret të tunden teksa kanë parë dritën që zbriste nga qielli.

### 51 vdekje nga rrëzimi i aeroplanit, kapiteni qante gjatë fluturimit

Aksidenti i avionit në aeroportin ndërkombëtar të Nepalit, që i mori jetën 51 personave, ndodhi për shkak se kapiteni pësoi një "shpërthim emocional". Hetuesit thanë se kapiten Abid Sultan qante gjatë fluturimit, pasi një bashkëpunëtor kishte vënë në dyshim aftësitë e tij. Fluturimi i 12 marsit nga Bangladeshi u rrëzua në aeroportin e Kathmandu dhe rrëshqiti deri në një fushë futbolli, ku shpërtheu në flakë, duke vrarë 51 persona. Ky ishte aksidenti më vdekjeprurës i aviacionit në Himalaya për dekada të tëra. Monologu i vazhdueshëm i kapitenit çoi në "çorientimin total" të bashkëpilotit, ç'ka çoi në rrëzimin e avionit. Prithula Rashid ishte kualifikuar së fundmi dhe nuk kishte zbritur më parë në aeroportin e Kathmandu. Në kopjen e raportit përfundimtar të hetimit. e parë nga AFP, thuhej se kapiteni ishte "nën stres dhe i shqetësuar emocionalisht", pasi një bashkëpunëtor kishte vënë në dyshim reputacionin e tij si një instruktor i mirë.

## Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Pupi regjisor.
5. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve
11. Turner aktore.
12. Fillojnë festat.
13. Skuadër greke.
14. Falen pa fe.
15. U shkrua nga Gorkij.
18. Një sferë për... model.
19. Janë bisha.
22. Parashtesë për dy.
23. Demoni që persekutonte Sarën.
24. Stacion i famshëm orbital.
25. Mendes regjisor.
27. Një rrethi i ngushtë miqësor
29. Film me Robert de Niro dhe Jean Reno
30. Këndohen në opera.
32. Është lajm i vjetër.
34. Sharif aktor.
35. Martin i Norma Rae.
36. Mund të jenë filmi.
38. Një jepet për hartim.
39. Ami i Maupassant.
41. Fundi i Turandot.
42. Halili këngëtare.
45. Neill i Jurassic park.
47. Pineda e Garcia Lorca-s.
48. Giorgio stilist

VERTIKAL
1. Morissette këngëtare.
2. Kilmer aktor.
3. Heche aktore.
4. Fillojnë tatëpjetën
5. Është diapozitiv shumë i ndjeshëm.
6. Mbyllin spitale.
7. Në krye të masave.
8. Bëjnë shirit me shi.
9. Qe vajza e Tantalit.
10. Janë më shumë se dëshira
12. Ishte dekret i sulltanit.
15. Qe mbreti i urtë i Pilos.
16. Quinn aktor.
17. Gasol i NBA.
20. Fillojnë garën.
21. Një pjesë e reformave.
26. Është si biskotë.
28. Mund të jetë karmelitan.
29. Sjellin shi.
30. Bel i Maupassant.
31. Direk pa ekstreme.
33. Gjysma e bimëve.
34. Mbyllin një motor.
36. Është bitum.
37. Fara këngëtare.
38. Hanks aktor
39. Stiller aktor.
40. Morrison rockstar.
42. Fillojnë masat.
43. Në krye të tabelës.
44. Derisa janë në fund.
46. Fund filmi.

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Film i hitchock.
6. Fillojnë premierën.
7. Janë legjendat.
11. Kush ka... ka zët.
12. Thurman aktore.
15. Një pjesë e testamentit
16. Një pjesë e studimeve.
18. Kështu është situata e tensionuar.
21. Telefoni në kartëvizitë.
22. Është ngasje.
24. Në krye të autoriteteve.
25. Mbyllin mbledhjen.
26. Pason abetaren.
28. Nisin nga kreu.
29. Fillojnë aafrimin.
30. Cocker këngëtar.
31. Bartok kompozitor.
33. Tiriac që qe tenist.
35. Oxa këngëtare.
36. Kalimi në ekstreme.
37. U shkrua nga Zola.
39. Fise pa fe.
40. Është mballomë.
41. I mungon apatikut.
43. Një pjesë e medaljeve.
44. Një këngëtar lirik.
46. Pak torturuese.
48. Ka privilegjin e jetës.
51. I famshmi Pacino.
52. Nasi shkrimtar.
53. Janë temperaturat më të ulëta.
54. Me pit në box.

VERTIKAL
1. Janë enigmatikë.
2. Emri i Vivaldit.
3. Rrjedh në klepsidër.
4. Inicialet e Selleck aktor.



5. Fillojnë rubrikën.
6. Ishte babai i Proknit dhe Filomelës.
8. Vitet pa kufij.
9. Mbyllin kanate.
10. U shit për një pjatë thjerza.
13. ... e shëndoshë në trup të shëndoshë.
14. Moore aktore.
17. Rocca aktore.
19. Janë përmasa.
20. Fund dhjetori.
23. Mbyllin krahun.
26. Fillojnë kalimin.
27. Duhen ruajtur.
32. Ishte Europa komuniste.
34. Agjenci Kombëtare Lokale
38. Berg kompozitor.
40. Të parat në Amsterdam.
42. Elsa këngëtare.
45. Memoria në computer
47. Me të nxjerrin trarë.
49. Në mes të dhomës.
50. Ekstreme kateti.
52. Kufijtë e lutjes.

## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | | 8 | 1 | 3 | | 4 | 9 | |
| | | 7 | | | | 6 | | 8 |
| | | 4 | 8 | | | | | 3 |
| 4 | | | | | | 1 | | |
| 3 | | | 2 | | | | | |
| | | | 9 | 1 | | | 8 | |
| 5 | 7 | | | 9 | | | | |
| | | 6 | | | 5 | | | |
| 9 | | | 6 | | | 5 | | |

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | 9 | 1 | 8 | 5 | 7 | 4 | 6 | 2 |
| 4 | 6 | 7 | 9 | 1 | 2 | 5 | 3 | 8 |
| 5 | 2 | 8 | 3 | 6 | 4 | 7 | 9 | 1 |
| 6 | 3 | 2 | 4 | 7 | 5 | 8 | 1 | 9 |
| 7 | 4 | 9 | 1 | 2 | 8 | 3 | 5 | 6 |
| 8 | 1 | 5 | 6 | 3 | 9 | 2 | 4 | 7 |
| 9 | 7 | 3 | 5 | 8 | 1 | 6 | 2 | 4 |
| 2 | 5 | 4 | 7 | 9 | 6 | 1 | 8 | 3 |
| 1 | 8 | 6 | 2 | 4 | 3 | 9 | 7 | 5 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| E | R | A | S | M | I | ■ | P | A | K | E | T | A | T |
| L | O | R | I | S | ■ | K | U | M | A | R | I | ■ | R |
| U | N | I | K | ■ | S | A | N | ■ | P | ■ | ■ | S | E |
| A | ■ | A | ■ | M | E | S | I | M | O | R | E | ■ | G |
| R | B | ■ | M | E | R | E | M | E | T | I | M | E | T |
| D | E | L | I | K | A | T | E | T | ■ | V | ■ | L | A |
| ■ | S | A | R | A | F | E | T | ■ | R | A | C | E | R |
| P | I | R | A | T | I | ■ | ■ | M | O | L | I | N | E |
| ■ | M | I | G | E | N | A | ■ | A | R | E | N | A | T |
| B | E | S | E | ■ | E | T | E | R | ■ | T | I | ■ | ■ |
| A | T | A | ■ | E | T | A | ■ | S | A | ■ | K | R | A |
| N | ■ | ■ | A | R | ■ | K | R | I | ■ | T | E | M | A |

FJALEKRYQI (2)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P | A | Z | A | R | ■ | K | A | B | I | N | E | T | ■ |
| I | R | O | N | ■ | M | ■ | B | E | T | I | M | ■ | Z |
| T | M | ■ | E | K | E | ■ | E | T | ■ | T | R | I | O |
| T | A | R | T | A | R | ■ | T | O | N | ■ | I | O | N |
| ■ | T | M | ■ | T | I | T | A | N | E | T | ■ | N | A |
| K | A | ■ | S | A | M | A | R | I | T | A | N | E | ■ |
| E | ■ | L | I | M | A | N | E | ■ | E | ■ | D | S | H |
| ■ | S | O | L | A | N | A | ■ | K | T | ■ | E | C | E |
| T | U | B | O | R | G | ■ | U | R | ■ | E | R | O | S |
| O | D | ■ | S | A | A | ■ | R | E | N | D | I | ■ | A |
| K | A | N | ■ | N | ■ | S | A | R | A | H | ■ | E | P |
| E | N | D | E | ■ | K | A | T | E | T | E | ■ | T | I |

## Argëtim filozofik

- Asnjë njeri i cili nuk është i gatshëm për të ndihmuar veten e tij nuk duhet t'u lutet për ndihmë miqëve apo perëndive.

- Një njeri i cili vazhdimisht deklaron se nuk është budalla, duhet të ketë dyshimet e tij.

- Nëse lexoni vetëm librat që lexojnë të gjithë të tjerët, ju vetëm mund të mendoni atë që të gjithë të tjerët mendojnë.

## KRIPTOSKEME



## KRIPTOSKEME
### Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ■ | T | F | ■ | S | T | O | P | ■ | ■ | K | P |
| F | I | E | R | ■ | ■ | H | A | R | P | A | ■ |
| O | F | ■ | E | K | A | ■ | S | A | I | ■ | S |
| K | O | ■ | F | A | N | A | T | I | K | E | T |
| A | ■ | F | E | N | O | M | E | N | A | L | E |
| ■ | K | A | R | A | M | E | L | E | ■ | I | R |
| K | ■ | N | A | D | A | R | ■ | R | R | O | ■ |
| O | ■ | I | T | A | L | I | A | ■ | R | ■ | ■ |
| F | A | ■ | E | ■ | I | K | O | N | A | T | ■ |
| I | R | ■ | T | O | T | A | L | I | T | A | R |
| N | A | F | ■ | D | E | N | ■ | S | H | T | ■ |
| I | T | E | R | E | ■ | E | D | ■ | E | A | P |

## Thënie të mençura

-Sa e kënaqshme është për të takuar njerëz të cilët janë më injorantë se ne! Menjëherë i simpatizojmë që janë kështu.

- "Etj" është shenja që ne përdorim për të treguar se ne supozojmë se dimë më shumë se sa themi.

- Eekzistojnë krime më keq se sa të djegësh libra. Një nga këto është të mos i lexosh.

- Nëse keni problem, jeni lënduar ose keni nevojë, shkoni tek njerëzit e varfër. Ata janë


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al